



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Teknikë Laboratori Mjekësor”

Universiteti “Aldent”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr Anila Hoda

Pro. As Rezarta Lalo

Handwritten signatures of Prof. Dr Anila Hoda and Pro. As Rezarta Lalo.

Shkurt / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në “Teknikë Laboratori Mjekësor” ofruar nga Universiteti “Aldent”**

1	IAL aplikues:	Universiteti “Aldent”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Laborant Mjekësor dhe Imazheri
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Teknikë Laboratori Mjekësor”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MAS Nr. 187, datë 22.04.2016
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 354, datë 26.11.2019.
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 68, datë 04.10.2019
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2021-2022 21 PAE / 10 PAK; 2022-2023 263 PAE / 10 PAK; 2023-2024 24 PAE / 10 PAK;
18	Numri i studentëve:	2021-2022 62studentë; 2022-2023 59 studentë; 2023-2024 67 studentë;
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti Aldent (UAL) është një institucion i arsimit të lartë jo publik me një përvojë prej 20 vitesh në fushën e edukimit në Shqipëri. Institucioni ka zhvilluar një profil të rëndësishëm në arsimin e lartë, duke qëndruar për ofrimin e standardeve më të larta në mesimdhënie dhe aktivitete të tjera akademike dhe shkencore. Për të arritur këtë qëllim, UAL ka kaluar nëpër disa procese akreditimi dhe riakreditimi, që kanë ndihmuar në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit.

Programi i studimit Bachelor në "Teknikë Laboratori Mjekësor" është licensuar sipas Urdhërit MAS Nr. 187, datë 22.04.2016. Programi i studimit është akredituar për herë të parë me VBA Nr. 68, datë 04.10.2019.

Programi Bachelor në "Teknikë Laboratori Mjekësor" është një prej programeve të ofruara nga UAL në fushën e shkencave mjekësore. Ky program është i organizuar dhe i përditësuar në përputhje me legjislacionin arsimor dhe aktualizimet e mëvonshme, duke filluar me akreditimin e parë dhe duke u përshtatur me ndryshimet e kërkesave ligjore dhe akademike.

Fokusi i këtij programi është të formojë profesionistë të mirefilltë në fushën e laboratorëve mjekësore, duke përfshirë një kombinim të thellë të formimit teorik dhe praktik. Struktura dhe përmbajtja e programit janë në përputhje me nevojat dhe standardet e tregut të punës, duke i përgatitur studentët për sfidat dhe detyrat e profesionit në të ardhmen. Organizimi i programit dhe metoda e mësimdhënies sigurojnë një formim të përshtatshëm për studentët, duke u siguruar një bazë të qëndrueshme për karrierën e tyre në fushën e shëndetësisë. Përgjatë programit të studimit, vëmendje i kushtohet edhe transferimit të njohurive dhe aftësive profesionale, duke filluar nga lëndët themelore mjekësore deri te materialet karakterizuese të profesionit. Kjo përjasje siguron që studentët të përgatiten për t'u bërë pjesë e suksesshëm në fushën e laboratorëve mjekësore pas diplomimit.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Ne kuader të akreditimit të programit të studimit Bachelor në "Teknikë Laboratori Mjekësor", i ofruar nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike në Universitetin "Aldent", Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) i përbërë nga Prof. As Anila Hoda, dhe Prof. As Rezarta Lalo dhe koordinatorë teknike të ASCAL Msc. Majlinda Demirneli, kanë hartuar Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, i cili është një dokument që përmbledh vlerësimin përkundërs standarteve dhe kritereve të akreditimit për programin e studimit. Ky dokument u hartua në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. Ky proces ka për qëllim të identifikojë nivelin e përmbushjes së standarteve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë.

Bazuar në afatet e përcaktuara dhe procedurën e vlerësimit procesi u realizua në disa faza:

- Vleresimi i brendshem ku Institucioni ka dorezuar Dosjen e Vetvleresimit, e cila perbehet nga Raporti i Vleresimit te Brendshem dhe evidencat mbeshetese.
- Percaktimi dhe trajnimi i eksperteve te jashtem nga ASCAL bazuar ne "Manualin per Procedurat dhe Afatet per Vleresimin e Cilesise ne kuader te Akreditimit te Institucioneve te Arsimit te Larte dhe programeve te studimit 2017". Gjate kesaj faze, ASCAL i ka vene ne dispozicion GVJ gjithë dokumentacionin e nevojshem, i cili eshte shqyrtuar dhe jane realizuar takime dhe diskutime ne kuader te planifikimit te axhendes per viziten institucionale.
- Vizita ne UAL e zhvilluar ne datat 11–12 prill 2024 ku GVJ realizoi takimet sipas axhendes se vizites ne IAL me drejtues te institucionit, staf akademik, perfaqesues te Zyres se Burimeve Njerezore, Zyres se Karrieres dhe Alumnit, GVB, studente etj. Gjate ketyre takimeve u zhvilluan intervista, u moren informacione te rendesishme ne lidhje me programin e studimit dhe u vizituan mjediset e institucionit si biblioteka, auditoret, labororet, sherbimet per studentet. GVJ vleresoi gadishmerine e institucionit per ofrimin e informacioneve te kerkuara ne funksion te procesit ne viziten institucionale.

Dorezimi i draft– raportit paraprak prane ASCAL dhe pergatitja per finalizimin e tij. Raporti i vleresimit te jashtem permban 6 fusha vleresimi:

- I. Ofrimi i programit te studimit
- II. Organizimi, drejtimi dhe administrimi I programit te studimit
- III. Mesimdhenia, mesimnxenia, vleresimi dhe kompetencat
- IV. Burimet njerezore, financiare, infrastruktura, logjistika per realizimin e programit te studimit
- V. Studentet dhe mbeshtetja e tyre
- VI. Sigurimi i cilesise ne programin e studimit

Shkalla e permbushjes se standarteve per cdo fushe eshte percaktuar ne 4 nivele:

- Standartet nuk permbushen
- Standartet permbushen pjesesisht
- Standartet permbushen kryesisht
- Standartet permbushen plotesisht

Gjate hartimit te draft/raportit GVJ ka marre ne konsiderate informacionet gjate vizites institucionale dhe ka shqyrtuar me kujdes dokumentacionin e vene ne dispozicion. GVJ eshte perpjekur te pershkruaje me korrektesi dhe profesionalizem gjetjet, konstatimet dhe shkallen e cilesise te programit te studimit te ofruar nga Universiteti "Aldent". Ne perfundim te ketij procesi, GVJ ka dorezuar draft/raportin ne ASCAL.

Universiteti "ALDENT" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 26.12.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 127/11 Prot, datë 26.12.2024. Universiteti "ALDENT", njofton më datë 08.01.2025, nëpërmjet shkresës me nr. 2 / 1, prot, datë 07.01.2025," *Kthim përgjigje për Draft RVJ e programit të studimit Bsc në "Teknikë Laboratori Mjekësor"*.

Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

1. **Lidhur me komentin mbi plotësimin e rekomandimit të lënë në akreditimin paraardhës,** GVJ shqyrtoi dhe vlerëson shpjegimin e institucionit, duke reflektuar edhe ndryshimin e gjetjes në raport, që tematikat që lidhen me biofizikën dhe optikën janë të integruara në programin e modulit "Teknika Laboratorike 2", dhe tematikat që lidhen me automatizimin e laboratorëve dhe sistemeve të informatizimit laboratorik, janë të integruara si pajisje në laboratorin e sektorit biokimik. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**
2. **Lidhur me komentin në standartin IV.1 rubrika "konkluzione",** GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por i qëndron formulimit në tekst duke theksuar se GVJ është bazuar në (*dokumentin nr. 23, tab 5.1-5.3*), ku rezulton se në mësimdhënie në këtë program studimi ka edhe staf me Bsc, gjithsesi ashtu sic e kemi theksuar është një % e vogël, ku nuk e çënon përmbushjen e këtij standarti. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
3. **Lidhur me komentin në standartin IV.3 kriteri 2,** GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por i qëndron formulimit në tekst duke theksuar, që pavarësisht se është material i përkthyer nga literaturë e aprovuar ajo mund të citohet përsëri në syllabus si referencë bibliografike dhe jo thjesht leksione të përgatitur nga pedagogu. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
4. **Lidhur me komentin në standartin V.4 kriteri 5,** GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por i qëndron formulimit në tekst duke theksuar se GVJ nuk gjeti evidencë për të vlerësuar shkallën dhe cilësinë e punësimit të studenteve, informacion i cili duhet të pasqyrohet qartë në raportin analitik institucional duke u shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
5. **Lidhur me komentin në standartin VI.1 kriteri 1,** GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, duke reflektuar edhe ndryshimin e gjetjes në raport, duke konsideruar (dok 20 përshkrimi i laboratorëve në funksion të programit), dhe ambientet e para gjatë vizitës në instiucion për mësimdhënie interaktive dhe immersive, pajisje moderne laboratorike etj. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**

Albi R. Hoxha

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 68, datë 04.10.2019 janë:

1. Institucioni, të rekrutojë staf të ri akademik, me qëllim uljen e ngarkesës së lartë në numër lëndësh të disa prej anëtarëve të stafit akademik aktual të angazhuar në këtë program studimi si dhe mbulimin e të gjitha lëndëve me ekspertë të fushës.
2. Institucioni, në të ardhmen, në kuadër të përmirësimit të planit mësimor, të shohë mundësinë e përfshirjes në lëndë të veçanta tema apo leksione për Mjekësinë Transfuzive, Onkologjinë, Vlerësimin e Sëmundjeve Reumatizmale, Obstetrikën, Biofizikën, Optikën, Automatimi në Laboratorët Mjekësorë dhe Sistemet e Informatizimit Laboratorik (LIS), etj.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Lidhur me rekomandimin e pare, nga akreditimi i fundit që lidhet me rekrutimin e stafit të ri me qëllim uljen e ngarkesës së lartë në numër lëndësh si dhe mbulimin e të gjitha lëndëve me ekspertë të fushës, GVJ për akreditimin aktual konstatoi se ky rekomandim është adresuar nga institucioni, i cili ka rekrutuar staf të ri dhe si rrjedhojë stafi aktual i angazhuar në programin e studimit nuk jep më shumë se 3 lëndë, në përputhje me bazën ligjore në fuqi (Ev. 23, tab 13). Gjithashtu, në përmbushje të rekomandimit, u evidentua se të gjitha lëndët mbulohen nga ekspertë të fushës (Ev. 23, tab 5-5.3; Ev 28.1/2). Megjithatë, u konstatua se në këtë program studimi Bachelor, angazhohen edhe staf akademik me Bsc (edhe pse numër shumë i vogël). Sipas përcaktimeve ligjore, personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës, prandaj institucioni duhet të marrë masa që të angazhojë në mësimdhënie vetëm personel akademik me të paktën Msc. Nga sa më sipër GVJ konsideron se **ky rekomandim është përmbushur plotësisht.**

Lidhur me rekomandimin e dytë, nga akreditimi i fundit, institucioni në kuadër të përmirësimit të planit mësimor ka përfshirë si lëndë të veçanta lëndët: "Shëndet riprodhues" dhe "interpretim të rezultateve laboratorike", "Vlerësim laboratorik të sëmundjeve reumatizmale", "Onkologji dhe markuesit tumoralë". Gjithashtu, në lëndë të veçanta si "Hematologji dhe hemostazë", "Organizim dhe teknikat laboratorike" ka përfshirë disa leksione respektivisht për Mjekësinë Transfuzive dhe Automatimin në Laboratorët Mjekësorë. Në lidhje me lëndët Biofizika, dhe Optika janë integruar tematika në programin e modulit "Teknika Laboratorike 2", duke paraqitur mënyrën e funksionimit e aparaturave laboratorike. Ndërsa në lidhje me përfshirjen e automatizimit të laboratorëve dhe sistemeve të informacionit laboratorik, është integruar si pajisje në Laboratorin e sektorit Biokimik që përdoret nga studentët e këtij programi. Nga sa më sipër GVJ konsideron se **ky rekomandim është përmbushur plotësisht.**

Alta Refay

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Teknikë Laboratori Mjekësor”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti "Aldent" ofron programe studimi që respektojnë ligjet dhe interesat kombëtare, duke promovuar vlerat akademike dhe kulturore kombëtare sipas Statutit të tij (Ev.1. Statuti i Universitetit Aldent). Studentët përfitojnë jo vetëm njohuri profesionale, por edhe ndjenjë humaniteti dhe përkushtim ndaj interesit kombëtar në mjedisin e arsimit. Kjo tregon angazhimin e qartë të universitetit për ruajtjen dhe përparimin e trashëgimisë kombëtare në arsimin e lartë.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit i ofruar nga Universiteti "Aldent" është në përputhje me synimet dhe misionin e institucionit, siç paraqitet në statutin e tij. Ky program synon të pajisë studentët me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të punuar në fushën e teknikave laboratorike, duke përfshirë proceset diagnostikuese dhe kërkimore në mjekësi. Përtej kësaj, programi përfshin formimin profesional, intelektual dhe etik për të siguruar përshtatshmërinë e studentëve në praktikën profesionale në mënyrë teknike, ligjore dhe morale.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Sipas strategjisë së Aldent, misioni i Universitetit përfshin: - Ofrimin e arsimit të lartë dhe veprimtarisë krijuese për studentët në fushën mjekësore me qëllim realizimin e synimeve të tyre profesionale brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë; - Zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike; - Formimin e studiuesve të rinj në fushat mjekësore, nëpërmjet programeve universitare mësimore-shkencore të një niveli të përparuar e bashkëkohor teorik, metodik e praktik; - Thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialisteve të lartë në fushat mjekësore, duke ofruar mundësi të mira për të përfutur nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës; - të kontribuojë në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit;

Alta Rekey

</

	Njësia Bazë ka 3 staf ndihmës akademik, Institucioni demonstron se ka kapacitetet dhe burimet e duhura për ofrimin e këtij programi studimi. Aldent është akredituar më herët (Ev.23, Tabelat)			
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Universiteti Aldent është institucion i cili ofron programe studimi vetëm në fushën e shkencave Mjekësore. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike të ofruar nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike i cili ofron këtë program studimi, ka në përbërjen e vet këto njësi bazë: 1. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë; 2. Departamenti Laborant Mjekësor dhe Imazheri; 3. Qendra e Promovimit të Shëndetit; Programi i studimit ofrohet në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri”, sipas VKM nr. 41 datë 24. 01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga insitucionet e arsimit të lartë”, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Kodifikimi i programit është propozuar dhe dërguar në MAS, bazuar në Klasifikimin Standard të Arsimit KSNA 2011 dhe Fushat e Arsimit dhe Trajnimit KSNA-se (Ev.23, Tabela 1).			
Konkluzione	<i>GVJ konfirmon se programi i studimit i Universitetit Aldent përputhet me misionin dhe synimet e institucionit, duke u fokusuar në zhvillimin e njohurive në teknikat laboratorike mjekësore.</i> <i>Programi respekton udhëzimet kombëtare dhe evropiane për klasifikimin e arsimit dhe është miratuar nga MAS.</i> <i>Universiteti ka përvojë të gjatë dhe ka investuar në infrastrukturë e burime njerëzore për të garantuar cilësi akademike në përputhje me standardet ligjore dhe akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2



Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Neni 8 i statutit dhe neni 3 i Rregullores së Universitetit përcaktojnë organigramën dhe strukturën akademike dhe administrative të UAL. Organigrama e Institucionit përcakton Njësitë Akademike dhe jo akademike. Në UAL janë të përfshira Njësi Kryesore, njësi Bazë, Njësi Administrative si dhe Komisione të përhershme. Të gjitha këto njësi bashkëpunojnë me njëra tjetrën në bazë të detyrave të përcaktuara. (Fv.1; Fv.3,1; Fv.3,2; Ev.16)
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Universiteti Aldent ka ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me institucione shëndetësore publike dhe private, për të realizuar efektivisht procesin mësimor (Takimi me partnerët). Prioritet i është dhënë bashkëpunimit me Universitetin e Mjekësisë Tirane për shkëmbim reciprok të stafit, organizim të konferencave dhe aktiviteteve akademike të përbashkëta, si dhe botime të përbashkëta (Takimi me stafin akademik). Këto marrëdhënie të ngushta kanë qenë thelbësore në përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe trajnimit mjekësor në nivel vendi.
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Për realizimin e praktikave laboratorike, Universiteti Aldent ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucionesh të rëndësishme në fushën e shëndetësisë. Këto përfshijnë Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, Institutin e Shëndetit Publik, Genius SHPK, Intermedica, dhe Operatorin Vendor të Kujdesit Shëndetësor në Tiranë. Ky bashkëpunim është dokumentuar në dokumentet Ev.9 dhe Ev.19, që shërbejnë si prova e lidhjeve të thella dhe të qëndrueshme të Universitetit Aldent me institucionet të rëndësishme të fushës së shëndetësisë.
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte	Koordinatori i programit të studimit harton raporte mbi ecurinë e programit të studimit. Në bashkëpunim me përfaqësues të Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë raporton dhe mbi ecurinë e implementimit të marrëveshjeve të cilat janë në

analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	funksion të programit Bachelor në "Teknikë Laboratori Mjekësor". (Ev.22, takimi me NJSBC)			
Konkluzione	Universiteti "ALDENT" ka rikonfiguruar strukturën e tij organizative sipas ligjit për arsimin e lartë dhe Statutin e tij. Ai ka vendosur bashkëpunime me institucione homologe dhe shëndetësore për të përmirësuar cilësinë e arsimit mjekësor. Për praktikën laboratorike, universiteti ka marrëveshje me institucione si Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe Instituti i Shëndetit Publik. Njësia përgjegjëse monitoron dhe raporton periodikisht përfitimet nga këto bashkëpunime.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i Studimit në "Teknikë Laboratori Mjekësor" është i strukturuar në module dhe lëndë, duke u bazuar në legjislacionin vendas dhe në Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Për të qenë në përputhje me ndryshimet në legjislacion dhe VKM 41, 2018, programi është adaptuar në mënyrë të përshtatshme. Lëndët janë të organizuara në kategori të ndryshme si lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe plotësuese, për të siguruar një formim të plotë dhe specifik për studentët në këtë fushë. Këto përmirësime dhe përshtatje janë të dokumentuara në tabelat 11 dhe 12 (Ev. 23), duke treguar angazhimin dhe përpjekjet e institucionit për të siguruar një program studimi të aktualizuar dhe në përputhje me standardet e nevojshme.
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit në "Teknikë Laboratori Mjekësor" synon të formojë shprehje të veçanta, duke ofruar njohuri të përparuara dhe zhvilluar aftësi dhe kompetenca të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse në fushën laboratorike. Struktura e plotë e programit është bazuar në praktikën më të mirë, duke integruar mësimin teorik dhe praktik. Ky program synon të pajisë studentët me njohuri dhe aftësi profesionale dhe shkencore, duke i përgatitur ata për tregun e punës dhe studimet e mëtejshme. Objektivat e programit janë të përshtatura me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimet në fushën e shkencave mjekësore, duke përfshirë edhe teknikat laboratorike specifike (Ev. 24). Programi i studimit ofron mundësi për punësim në spitalet, klinikat dhe laboratorët mjekësorë, duke adresuar kërkesat aktuale dhe të ardhshme të tregut të punës në këtë fushë (Takimi me bashkepunetoret).
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Programi është i organizuar në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), duke përfshirë një total prej 180 kredive ECTS në 3 vite studimi, të shpërndara në 16 semestra (Ev.23. Tab 22). Lëndët dhe modulet janë grupuar sipas kategorive të formimit dhe kanë një ngarkesë të përshtatshme në kredite. Programi i studimit përmban të gjitha elementet e nevojshme sipas ligjit 80/2015, VKM nr. 41, datë 24.01.2018 dhe aktet

	nënligjore për organizimin e strukturës së një programi studimi (Ev.17. Rregullorja e programit).
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit ka të përcaktuar një ngarkesë në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse, siç është paraparë në planin e mësimi (Ev.23. Tab 10, 22). UAL ka një qasje të strukturuar dhe të përcaktuar për të siguruar që studentët të përmbushin praktikat profesionale dhe detyrimet përmbyllëse në mënyrë të plotë dhe efektive në kuadër të programit të tyre të studimit.
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Universiteti Aldent është një institucion i arsimit të lartë, jopublik, që organizon dhe ushtron veprimtari akademike, kërkimore dhe shkencore në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi për arsimin e lartë (Ev.1, Statuti i Universitetit Aldent). Kjo tregon që Universiteti Aldent ka respektuar dhe zbatuar ligjin për arsimin e lartë dhe ka ndjekur specifikat e përcaktuara nga Ministria e Arsimit, duke bërë kështu të mundur organizimin, pranimin e studentëve dhe financimin në përputhje me kërkesat dhe rregullat ligjore të përcaktuara.
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit "Teknike Laboratori Mjekësor" në Universitetin Aldent ka një përmbajtje të ngjashme në nivel të paktën 70% me programet e të njëjtës fushë studimi në vend dhe në nivel ndërkombëtar. Ky program është hartuar dhe përditësuar duke u bazuar në direktivat e Bashkimit Evropian dhe ECT Guide, në përputhje me Konventën e Lisbonës për programe të njëjta, me synimin për lehtësimin e transferimit të studimeve dhe punësimit të studentëve në vend, Evropë, SHBA etj.
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	UAL ka bërë përpjekje që programi i studimit "Teknike Laboratori Mjekësor" të shoqërohet me kodin përkatës sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve publike të bëra nga ministria përgjegjëse për arsimin, siç kërkohet në nenin 86, pika 1 e Ligjit për Arsimit të Lartë (LAL) dhe udhëzimit 31, datë 15.12.2022. Universiteti ka propozuar kodifikimin në MAS për të gjitha programet e studimit që ofron me shkresë Nr. 22, protokoll datë 31.03.2023. Në sistemin e brendshëm të menaxhimit të sekretarisë FxEducation, ka një kodifikim të programeve të studimit dhe lëndëve/modulave për çdo program. (Ev.7)

Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky nuk është një program i përbashkët por ofrohet vetëm nga UAL.			
Konkluzione	<i>Programi është i organizuar sipas legjislacionit dhe Sistemit Evropian të Krediteve (ECTS), duke kombinuar mësimin teorik dhe praktik për një formim të plotë e specifik.</i> <i>Objektivat janë përshtatur me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimet e fushës së shkencave mjekësore.</i> <i>Programi përfshin kredite për praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse, në përputhje me planin e mësimi.</i> <i>Përmbajtja reflekton direktivat e BE-së dhe është në harmoni me programet e ngjashme në këtë fushë studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Programi i studimit ofrohet në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri”, dhe VKM nr. 41, datë 24. 01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga insitucionet e arsimit të lartë” ndryshuar me VKM nr 879/2019 dhe VKM nr.185/2021. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike përbëhet nga 3 njësi bazë: 1. Departamenti Laborant Mjekësor dhe Imazheri; 2. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë; 3. Qendra e Promovimit të Shëndetit;

Programi i studimit Bachelor “Teknikë Laboratori Mjekësor” është pjesë e Ciklit të Parë të Studimeve në strukturën akademike të Departamentit të Laborant Mjekësor dhe Imazheri, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike të Universitetit “Aldent”.

Në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, janë të angazhuar personel akademik efektiv dhe me kontratë, të cilët paraqiten në Aneks, *Tabelat Përmbledhëse, tabela 2.2.* për vitin akademik 2023-2024 janë si vijon:

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	
	PAE	PAK
Prof.Dr	-	1
Prof.Asoc	6	3
Dr/PhD	14	16
Msc	29	31
Gjithsej	49	51

Çdo njësi bazë është i përbërë nga të paktën 7 staf akademik, ku të paktën 3 prej tyre janë me gradë shkencore. Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, Departamenti Laborant Mjekësor dhe Imazheri përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë:

Tituj/ grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	-	-	-
Prof. Asoc.	1	2	1	3	1	2
Dr./PhD.	2	5	3	4	4	5
SPA	5	5	6	7	6	5
Msc.	5	7	4	5	5	7
Totali	13	19	14	19	16	19

Ev. 23;

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Referuar RVB dhe Ev. 23, merret informacioni që Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ka vetëm 1 personel ndihmës-akademik. Departamenti Teknik Laboratori mjekësor dhe

legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Imazheri është i angazhuar në përcjelljen e detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për programin e studimit. Evidentohet se ata kanë përfshirë personel akademik dhe ndihmës akademik që përmbushin detyrat e tyre me përkushtim dhe profesionalizëm. Jepen shembuj që tregojnë se anëtarë të stafit, jo vetëm që koordinojnë dhe jepin udhëzime për studentët gjatë praktikave laboratorike, por ata gjithashtu realizojnë praktikën laboratorike në një mënyrë të profesionalizuar në laboratorët e përcaktuara për këtë program (Ev. 20; takimi me stafin akademik; takimi me studentët) Përveç personelit me orar të plotë, Departamenti angazhon edhe staf laborantësh në kuadër të marrëveshjeve me spitalet, klinikat, dhe laboratorët për monitorimin e studentëve gjatë praktikave klinike. Ky angazhim i stafit dhe resurseve për të siguruar mbështetje dhe përkujdesje të plotë ndaj studentëve gjatë praktikës reflekton përgjegjshmërinë dhe përkushtimin e tyre për realizimin e qëllimeve të programit të studimit.
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Për programin e studimit UAL ka të përcaktuar koordinatorin e programit të studimit. Detyrat e tij përcaktohen qartë në Rregulloren e Njesisë Kryesore, <i>neni 11, pika 2.</i> Koordinatori është i përfshirë në të gjitha fazat e organizimit dhe monitorimit të programit, duke filluar nga ndërtimi i orarit deri te komunikimi me stafin akademik dhe drejtuesit e lartë të institucionit. Kjo përfshirje e tij ndihmon në sigurimin e qasjes së suksesshme të studentëve në program dhe në adresimin e çështjeve që mund të lindin gjatë vitit akademik. Duke përfshirë një raport vjetor të përmbledhur (Ev. 22), koordinatori siguron që procesi mësimor të vlerësohet dhe monitorohet në mënyrë efikase. Kjo demonstroi përkushtimin e FSHMT ndaj cilësisë së arsimit dhe mbështetjen për studentët dhe stafin akademik.
Konkluzione	<i>Programi është i organizuar sipas legjislacionit dhe Sistemit Evropian të Krediteve (ECTS), duke kombinuar mësimin teorik dhe praktik për një formim të plotë e specifik.</i> <i>Objektivat janë përshtatur me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimet e fushës së shkencave mjekësore.</i> <i>Programi përfshin kredite për praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse, në përputhje me planin e mësimin.</i> <i>Përmbajtja reflekton direktivat e BE-së dhe është në harmoni me programet e ngjashme në këtë fushë studimi.</i>

Alta Rety

Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Departamenti Teknik Laboratori Mjekësor dhe Imazheri disponon dokumentacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimit të ciklit të parë. Disponueshmëria e planeve mësimore, syllabuseve të moduleve, si dhe dokumentacioni për zhvillimin dhe monitorimin e programit tregon për një përgatitje të mirë dhe një përqendrim të drejtë për të siguruar që programi i studimit të përmbushë standartet akademike dhe të plotësojë nevojat e studentëve (Ev. 3.2). Në këtë mënyrë, departamenti shfaq përgjegjshmëri dhe përkushtim në ofrimin e programeve të studimit të ciklit të parë.
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit përmban një plan mësimor të detajuar, i cili përfshin informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, dhe orët në auditor/jashtë auditorit. Planifikimi mësimor është realizuar në mënyrë të qartë dhe të strukturuar, duke u bazuar në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 dhe praktikat më të mira të organizimit akademik. Veprimtaritë mesimore janë organizuar në 2 semestra, me një shpërndarje të përshtatshme të orëve mesimore në auditor dhe punës individuale të studentëve. Kreditet dhe lëndët janë përcaktuar në përputhje me udhëzimet dhe rregulloret e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, duke përfshirë një shqyrtim të kujdesshëm të ngarkesës së orëve mesimore dhe detyrimeve të punës individuale për studentët. Kjo tregon për një përgatitje të mirë dhe një përqendrim të drejtë për të siguruar që programi i studimit të përmbushë standartet akademike dhe të plotësojë nevojat e studentëve në aspektin mësimor dhe organizativ. (Ev. 23. Tabelat 10, 11, 12, 14, 22)
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët	Sipas nenit 37 të Rregullores së Njesisë Kryesore përcaktohen kriteret për fitimin dhe humbjen e statusit të studentit. Neni 50 i Rregullores së UAL përcakton kushtet për pranimin në ciklin e parë të studimeve. Nenet 3-6 të Rregullores së programit të

Alina Rokay

që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	studimit përcaktojnë qartë kushtet e pranimit, regjistrimit dhe shkëputjes ose rifillimit të studimeve. Neni 42 b i Rregullores së UAL përcakton transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. Procedura e transferimit të studimeve përcaktohet dhe në evidencën 6.2. Njohja dhe ekuivalentimi i studimeve përcaktohen dhe në nenet 68-69 të Rregullores së UAL-së. (Ev.16. Rreg. Dep, Ev.3.1. Rreg. UAL, Ev.6.2. Procedura e transferimit)
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë, duke përfshirë praktikën, seminarët, apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. Janë paraqitur programet e lëndëve të cilat janë të klasifikuara në kategori A, B, C, D dhe E. Programi i lëndës jep informacion mbi pedagogun që do të zhvillojë modulin/lëndën dhe semestrin kur zhvillohet, tipologjinë e modulit/lëndës kohëzgjatjen e modulit; kreditet ECTS; objektivat e modulit/lëndës; elementët e mësimdhënies; detyrimet e studentit; format e kontrollit të dijeve dhe vlerësimin e tyre, si dhe literaturën. Kjo tregon se programi i studimit është i strukturuar dhe i dokumentuar në mënyrë të plotë, duke siguruar që studentët kanë një informacion të qartë dhe të plotë për lëndët dhe aktivitetet e tyre në kuadër të programit të studimit. (Ev.27. Syllabuset e moduleve, Ev.23. Tabela 21, Ev.17)
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm, duke përfshirë syllabuset, literaturën, kriteret e pranimit, etj. Ky proces i përditësimit fillon nga njësia bazë dhe përfundon me miratimin përfundimtar nga Senati Akademik i UAL në fillim të çdo viti akademik. Megjithatë programi për Teknik Laboratori Mjekësorë nuk ka bërë ndryshime sasiore në module/lëndë, pedagogëve u është kërkuar të përditësojnë materialet me literaturë të publikuar pas vitit 2020. Ndryshimet në shëndetin global si pasojë e pandemisë së COVID-19 kanë sjellë gjetje dhe konsiderime të tjera, si shtimin e librave nga autore të njohur botëror, të botuar pas vitit 2020, në bibliotekën e FSHMT (Vizita në bibliotekë). UAL demonstroi një angazhim të vazhdueshëm për përmirësimin e përmbajtjes së programit dhe sigurimin e një eksperiencë të pasur të mësimi për studentët.

	(Ev. 26. Literatura e programit, Ev.12. Biblioteka, Librat e rinj)			
Konkluzione	<i>Institucioni disponon dokumentacionin e plotë për organizimin dhe përmbajtjen e programeve të studimit të ciklit të parë, bazuar në VKM nr. 41, datë 24.01.2018.</i> <i>Programi ofron informacion të qartë për kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, si dhe për strukturën e lëndëve dhe aktiviteteve.</i> <i>Përditësimi i vazhdueshëm i programit pasqyron angazhimin për përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e një eksperience të pasur për studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës dhe vazhdimin e studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi, përmbajtja dhe shpërndarja e lëndëve sigurojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të nevojshme për punësimin e studentëve. Në planin mësimor përfshihen leksione, seminare, ushtrime, laboratore, praktikë profesionale dhe detyra/projekte. Përmes këtyre studentët kanë mundësinë të rrisin njohuritë dhe aftësitë e tyre. Njohuritë dhe aftësitë që përfitohen nga ky program studimi prezantohen në syllabuset e lëndëve. Kjo përfshirje dhe qartësi e përmbajtjes së programit siguron që studentët të kenë një kuptim të thellë të materialeve dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në mënyrë efektive. Veçanërisht, praktikat laboratorike janë thelbësore për zhvillimin profesional të studentëve dhe ato janë një komponent i rëndësishëm i formimit profesional. Organizimi dhe objektivat e specifikuar për secilën lëndë tregojnë për një përqasje të përgjegjshme dhe të qëlluar për të siguruar që studentët të fitojnë njohuri dhe aftësi praktike të nevojshme për t'i përdorur ato në karrierën e tyre të ardhshme. UAL është i përkushtuar në sigurimin e një përmbajtje të programit të studimit që përmbush standardet akademike dhe adreson nevojat e studentëve për të

	qenë konkurrues në tregun e punës ose për studime të mëtejshme. (Ev.23. Tabela 22. Plani mesimor, Ev. 24. Programi i përmbledhur)
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	GVJ konstaton se lëndët e programit të studimit, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si dhe vlerësimi në kredite mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe të aftësimit profesional. Fillimi me formimin bazë, duke njohur studentët me nocionet kryesore të biologjisë, kimisë, biokimisë, mikrobiologjisë, anatomisë dhe fiziologjisë humane, pasuar nga konkretizimi profesional dhe praktik në module karakteristike të teknikave laboratorike dhe të tjera, siguron një përparim të rregullt dhe të strukturuar në zhvillimin e tyre. Sipas planit mësimor, parashikohen 34 kredite për lëndët bazë (18.8%), 93 kredite për lëndët karakterizuese (51.6%), 24.5 kredite për lëndët ndërdisiplinore (13.6%), 21.5 kredite për lëndët plotësuese (11.9%) dhe 7 kredite për detyrimet përmbyllëse (4%). Në program janë parashikuar lëndët dhe kreditet përkatëse, si dhe organizimi i tyre në orë mesimore dhe studim individual, në përputhje me udhëzimet dhe rregulloret e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, duke marrë në konsideratë edhe orientimet evropiane. Kjo tregon për një përjasje të përgjegjshme dhe profesionale për hartimin e planit të mësimdhënies, duke siguruar që studentët të përfitojnë një përmbajtje të qëndrueshme dhe të plotë në të gjithë fushat e tyre të studimit. (Ev. 23. Tabela 22 Plani mësimor, Ev. 24. Programi i përmbledhur)
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Struktura e programit për "Teknikë Laboratori Mjekësor" është hartuar duke u bazuar në vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018. Lëndët janë të organizuara në grupe në përputhje me veprimtaritë e parashikuara në legjislacion dhe përputhen me rregullat e formimit teorik dhe praktik, duke pasur parasysh nevojën për zbatim praktik të të gjitha procedurave mjekësore. Kjo siguron një përafërsi dhe një përputhje me programe të ngjashme ndërkombëtare, duke respektuar standardet e sistemit të Bolonjës në vendet ku ky sistem është zbatuar. (Ev. 23. Tabela 1. Ndarja e disiplinave)
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese	Institucioni paraqet një qasje të kujdesshme në përgatitjen e strukturës së programit, duke filluar me disiplinat e formimit të



dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	përgjithshëm dhe duke vazhduar në ato më specifike, të cilat përshtaten me programe të ngjashme në institucione të tjera. Duke treguar një qasje të kujdesshme në hartimin e strukturës së programit dhe duke u fokusuar në harmonizimin e disiplinave nga të përgjithshmet në më specifike, institucioni bën një përpjekje të dukshme për të siguruar që studentët përfitojnë nga një program i përshtatshëm dhe i plotë. Kjo përputhshmëri lehtëson transferimin e krediteve dhe mundëson një shkëmbim të suksesshëm të njohurive dhe aftësive midis institucioneve të ndryshme. Për më tepër, dëshmia se studentët që kanë vazhduar studimet e tyre në cikle të tjera nuk kanë hasur vështirësi shtesë dhe kanë gjetur punë me sukses, tregon për standardet e larta të programit në transferimin e studimeve, mobilitet dhe punësim pas përfundimit të studimeve.
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Bazuar në prioritetet shëndetësore dhe mendimet e marra, në UAL, politikat dhe masat për zhvillimin e programeve të studimit janë planifikuar dhe implementuar për të siguruar përshtatshmërinë e tyre me kërkesat e tregut të punës (Ev. 26). Syllabuset e programeve të studimit përmbajnë të gjitha elementët e nevojshëm, duke filluar nga informacioni i pasqyrës së lëndës, rezultatet e pritshme të nxënies, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijes, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm dhe literatura (Ev. 23). Gjithashtu, një pjesë e rëndësishme e syllabuseve është literatura bazë e detyrueshme dhe literatura ndihmëse, e cila përditësohet dhe koordinohet me drejtuesit e departamenteve për të siguruar që të përmbushen kërkesat e nevojshme për marrjen e kompetencave të kërkuara (Ev. 26). Koordinimi i përditësimit të përmbajtjes së syllabuseve me drejtuesit e departamenteve dhe monitorimi i realizimit të tyre në përputhje me syllabusin e miratuar tregon për një qasje sistematike dhe të përgjegjshme në procesin e përditësimit. UAL tregon përkushtim për përmirësimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të syllabuseve për të përmbushur nevojat e tregut të punës dhe për të siguruar që studentët të marrin njohuritë dhe aftësitë e duhura. Këto veprime të ndërmarra nga institucioni tregojnë për një angazhim të vazhdueshëm në përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit.
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e	Bazuar në përmbajtjen e programit të studimit dhe në veprimtaritë që zhvillohen, studentët përfshihen në një përvojë të pasur teorike dhe praktike. Ata përfitojnë dije të

dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	rëndësishme, aftësi dhe kompetenca që ata synojnë në fushën e teknikës të laboratorit. Kjo përfshin edhe përvojën e pedagogëve dhe ndihmën e ofruar nga infermierët në spitalet për të përmirësuar kompetencat dhe aftësitë e tyre profesionale (Ev. 24).			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit siguron për studentët një përgatitje të lartë, tërësore, teorike dhe praktike, duke u mundësuar që ata të përfshihen në trajnime profesionale për zgjerimin e njohurive në fusha të veçanta të klinikave, laboratorëve apo qendra spitalore. Kjo u jep studentëve mundësinë të vazhdojnë studimet e tyre në nivele të larta ose të integrohen në tregun e punës me një nivel të lartë kompetencash dhe aftësish profesionale (Ev. 23). Cilësia e studentëve në hyrje/regjistrim në programin e studimit është një faktor shumë i rëndësishëm. Ky indikator bën që procesi mësimor dhe veprimtaritë e tjera të zhvillohen me një qasje maksimale të përkushtimit, pasi studentët janë të motivuar për të marrë sa më shumë nga përmbajtja e programit të studimit dhe për të zhvilluar aftësitë e tyre në mënyrë efektive.			
Konkluzione	<i>Programi i studimit është i strukturuar për të zhvilluar njohuritë dhe aftësitë e studentëve si laborantë profesionistë, duke integruar lëndë teorike dhe praktika laboratorike të kujdesshme.</i> <i>Ai ndjek standardet e sistemit të Bolonjës dhe është hartuar kronologjikisht për një përparim të qartë në formimin e studentëve.</i> <i>Përmbajtja dhe syllabuset përditësohen rregullisht për të reflektuar kërkesat e tregut dhe literaturën më të fundit.</i> <i>Institucioni tregon përkushtim për cilësinë dhe ofron përgatitje të plotë, teorike dhe praktike, duke përfshirë trajnime profesionale për sfidat e ardhshme të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Në Universitetin Aldent, për përmirësimin dhe përshtatjen e përmbajtjes së programit të studimit me kërkesat e tregut të punës, njësitë përgjegjëse konsultohen me institucione partnere, të diplomuar, dhe aktorë të tregut të punës gjatë hartimit dhe zhvillimit të programit të studimit. Ky proces i konsultimit dhe marrjes së propozimeve mundëson universitetin të ofrojë programe të përditësuara dhe të përshtatura me kërkesat e aktualizuara të tregut të punës. Për të arritur këtë qëllim, programi mesimor mund të ndryshohet deri në 20% pas një propozimi dhe argumentimi në Senatin Akademik. Ky fleksibilitet në ndryshimin e programeve mesimore tregon angazhimin e universitetit për të përmirësuar dhe aktualizuar përmbajtjen e programeve të tyre për të adresuar nevojat e ndryshme të tregut të punës. Gjithashtu, prezenca e numrit të lartë të studentëve në laboratorë dhe institucione shëndetësore u jep atyre mundësi për të njohur dhe prezantuar veten nëpër mjedise pune potenciale për të ardhmen. Kjo favorizon punësimin e studentëve pas përfundimit të studimeve. Rekomandimet dhe mbështetja e personelit akademik gjatë studimeve ndihmojnë në gjetjen e punës pas diplomimit (Ev. 23, Tabela 8) Për më tepër, studentët e këtij programi në Universitetin Aldent në përfundim të studimeve janë të përgatitur për t'u nënshtruar provimeve teorike dhe praktike të licensimit dhe gjejnë punë pothuajse të gjithë. Kjo tregon për cilësinë e programeve të studimit dhe përputhjen e tyre me kërkesat e tregut të punës.
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Në Universitetin Aldent, studentët janë të përfshirë aktivisht në diskutime dhe procese vendimmarrëse nëpërmjet përfaqësimit të tyre në strukturat e institucionit si Senati Akademik, Njsbc, dhe komisionet e ndryshme sipas parimeve ligjore. Ata kanë një rol të rëndësishëm në procesin e përmirësimit të programit të studimit duke dhënë mendime dhe sugjerime për ndryshime dhe përmirësime. Studentët gjithashtu janë të përfshirë në grupet e punës për proceset e akreditimit dhe angazhohen në mënyrë serioze në këto procese. Kjo përfshirje e studentëve në të gjitha nivelet e vendimmarrjes dhe proceseve akademike tregon për një kulturë të hapur dhe bashkëpunuese në universitet, duke reflektuar dëshirën për të përmirësuar programet dhe për të adresuar nevojat e studentëve në mënyrë efektive (Ev. 3.5).



Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Departamenti i Teknikës Laboratorike Mjekësore dhe Imazheri në Universitetin Aldent ka një lidhje të ngushtë me Urdhërin e Infermierit, shoqatat profesionale dhe institucionet tjera për përditësimin dhe përshtatjen e objektivave të programit dhe moduleve karakteristike. Ky bashkëpunim është në përputhje me direktivat dhe programet e ngjashme evropiane dhe synon të reflektojë zhvillimet dhe propozimet e fundit në fushat e ndryshme, veçanërisht në mjekësi. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi, programi i studimit është në gjendje të përditësohet dhe përmirësohet në përputhje me nevojat dhe kërkesat aktuale të tregut të punës dhe fushave profesionale të lidhura me teknikën laboratorike dhe imazherin. Kjo siguron që studentët të përfitojnë një përmbajtje të aktualizuar me zhvillimet më të fundit në fushën e tyre të studimit, duke i bërë ata konkurrues në tregun e punës dhe në mjediset profesionale të tyre.			
Konkluzione	<i>Universiteti Aldent përmirëson programet e studimit në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke bashkëpunuar me institucione partnere, të diplomuar dhe aktorë të industrisë.</i> <i>Fleksibiliteti dhe përfshirja aktive e studentëve në proceset e përmirësimit dhe akreditimit reflektojnë një kulturë bashkëpunuese dhe të hapur.</i> <i>Bashkëpunimet me institucionet profesionale dhe shoqatat, në përputhje me standardet evropiane, sigurojnë përmbajtje të përditësuar që i bën studentët konkurrues dhe të përshtatur për sfidat profesionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	RVB përmban një analizë të përmbajtjes së programit të studimit dhe metodave të përdorura për të siguruar njohuritë dhe aftësitë e studentëve në mënyrë efektive. Kjo përfshin format e mësimdhënies të përdorura, siç janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit, projektet, praktikat profesionale dhe klinike, dhe orët e hapura (Ev. 17). Në veçanti, për tu vlerësuar është fakti se Universiteti Aldent ka përshtatur një gamë të gjerë metodash në mësimdhënie, duke përfshirë teknologjinë për të përmbushur qëllimet e tyre në mesimdhënie (Ev. 17). Gjithashtu, institucioni ndjek ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe respekton lirinë akademike (Ev. 23).
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Në takimin me studentët e këtij programi studimi, por edhe me stafin akademik të angazhuar në këtë program, vërehet një bashkëpunimi ngushtë mes stafit akademik dhe studentëve. UAL i kushton vëmendje të veçantë angazhimit të personelit akademik në përgjigje ndaj nevojave të studentëve, si dhe përdorimit të metodave alternative të mësimdhënies. Pedagoget janë të lirë duke përdorur metoda të ndryshme të mesimdhënies (takimi me stafin akademik), duke përfshirë edhe module të edukimit në distancë. Përdorimi i materialeve elektronike, video, teste, dhe forumeve ofrojnë një gamë të gjerë të mundësive për mësimnxënien. Në veçanti, ndërthurja e orëve të teorisë, punës laboratorike, detyrave dhe projekteve brenda një moduli lejon përdorimin e një varieteti metodash, duke përmirësuar cilësinë e mësimnxënies, veçanërisht në shkencat mjekësore. Kjo përshtatje e larmishme e metodave rrit përfshirjen e studentëve në procesin e mësimdhënies (takimi me studentët) duke zhvilluar aftësitë që janë kërkuar nga punëdhënësit, si aftësitë e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Universiteti Aldent mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike për t'i përputhur më mirë me rezultatet e pritshme të nxënies (takimi me stafin akademik). Institucioni promovon një mesimdhënie cilësore duke përfshirë praktikën më të përparuar akademike, të bazuar në ndërthurjen e teorisë me praktikën dhe përdorimin e teknologjisë së informacionit në mësimdhënie. Metodatat e

	mësimdhënies përfshijnë shpjegime teorike, demonstrime konkrete dhe aplikim direkt të procedurave laboratorike në laborator. Për të përmbushur këto qëllime, personeli akademik ka përvojë didaktike të përqendruar, përfshirë përvojën në institucione të huaja nëpërmjet programeve si Erasmus+ në vende si Turqia, Polonia, Lituania, Çeki, etj (Ev. 10), duke dëshmuar përkushtimin e institucionit për të avancuar kompetencat didaktike të stafit akademik dhe për të përshtatur praktikat më të mira të mësimdhënies me standardet ndërkombëtare.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik i Universitetit Aldent është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, duke përdorur metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive. Ata nxisin mendimin krijues, kritik dhe autonominë e përgjegjshmërinë tek studentët, duke siguruar udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë. Stafi akademik ka përvojë profesionale dhe akademike dhe kujdeset që të përdorë metodologji të ndryshme të mësimdhënies për të përfituar njohuri në auditor dhe inkurajuar studentët drejt literaturave bashkëkohore të teknikave laboratorike. Universiteti Aldent organizon trajnime të vazhdueshme për personelin akademik për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies duke fokusuar në pedagogji. Metodologjia e Universitetit Aldent ka për qëllim të vendosë studentin në qendër të vëmendjes dhe të angazhojë pedagogun në rolën e trajnuesit, lehtësuesit dhe ndihmësit të procesit mësimor. Kjo metodologji angazhon studentët në veprime konkrete dhe punë në grup, duke përfshirë prezantime të hapura që i aftësojnë ata në zhvillimin e koncepteve dhe mbrojtjen e tyre me arsyetim. Puna në grup ndihmon në zhvillimin e aftësive të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të ndërsjellë të përvojave, ndërsa prezantimet e hapura promovojnë aftësitë e komunikimit dhe prezantimit. Këto praktika bëjnë pjesë në vlerësimin përfundimtar të lëndëve dhe ndihmojnë studentët të përafrohen më shumë me realitetin profesional pas përfundimit të studimeve. (Ev. 23, Tabela 21)
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë	Universitetin Aldent vlerëson dhe përmirëson format dhe metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit e bën këtë vlerësim duke përfshirë studentët në proces dhe duke reflektuar mbi mendimet dhe këshillat e tyre.



periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Procesi i mesimdhënies në fushën e shkencave mjekësore është kompleks dhe kërkon metoda të ndryshme për secilën prej tyre. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format dhe metodat e mesimdhënies në përputhje me natyrën dhe profilin e lëndëve. Në kontekstin e zhvillimeve të pandemisë, zhvillimi i veprimtarive përmes platformës së edukimit në distancë është një objekt i përmirësimit të vazhdueshëm. Kjo përfshin përfshirjen e studentëve në këtë proces dhe reflektimin mbi mendimet dhe sugjerimet e tyre. UAL mbledh mendimet e studentëve përmes formave të ndryshme si diskutimet e drejtpërdrejta, takimet online, diskutime nëpërmjet platformës në formatet e saj, apo përmes pyetësorëve, dhe i analizon këto mendime në funksion të përmirësimit të metodologjisë së mesimdhënies (Ev. 11)
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mesimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mesimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mesimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mesimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Njësia kryesore Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike (FSHMT) është përgjegjëse për promovimin e praktikave të mira në mesimdhënie dhe për përmirësimin e tyre të vazhdueshëm. Ajo siguron trajnime të vazhdueshme me lektorë vendas dhe bashkëpunon me Zyren e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë (Takimi me përfaqësues të zyrës) për mundësitë e trajnimit të stafit akademik jashtë vendit në universitete prestigjioze. Këto trajnime adresohen për përmirësimin e aftësive të mesimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. Eksperiencat shumëvjeçare të personelit akademik janë të ndërthurura me personelin e ri, duke mundësuar kështu vijueshmëri të traditës së krijuar dhe njëkohësisht implementimin e metodave të reja të mesimdhënies. Kjo përputhje dhe bashkëveprim mes eksperiencës të vjetër dhe të re siguron një përmirësim të qëndrueshëm të praktikave të mesimdhënies në Universitetin Aldent. (Ev. 10)
Konkluzione	<i>Universiteti Aldent përdor një gamë të gjerë metodash mesimdhënieje, përfshirë leksionet, praktikat laboratorike, mësimin në distancë dhe teknologjinë e informacionit, duke vendosur studentin në qendër të procesit.</i>

	<i>Institucioni organizon trajnime për pedagogët dhe mbledh mendimet e studentëve për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies.</i> <i>Metodologjia përfshin punën në grup dhe prezantimet për zhvillimin e aftësive bashkëpunuese dhe komunikative.</i> <i>Strukturat akademike bashkëpunojnë për të përshtatur praktikat më të mira me standardet ndërkombëtare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregullore të ndryshme të cilat janë publike. Institucioni dhe njësitë kryesore kanë hartuar dhe zbatojnë këto akte rregulluese për të koordinuar mënyrën e testimit dhe vlerësimit të njohurive. (Ev. 3, 4, 17). Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve të cilat së bashku me rregulloren u bëhen të njohura studentëve javën e parë të çdo semestri akademik. Specifikat për zhvillimin e mesimdhënies në dy vitet e pandemisë janë përfshirë në rregulloren e posaçme për mesimdhënien online dhe testimin e njohurive, e cila u hartua dhe u miratua nga Universiteti Aldent në prill të vitit 2020. Kjo rregullore përcakton procedurat dhe kriteret e testimit dhe vlerësimit për mesimdhënien në mjedisin online, duke siguruar që procesi të jetë i transparent dhe i drejtë për studentët.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e	Në fillim të çdo lënde/moduli stafi akademik informon studentët për lëndën/modulin, metodologjinë e mesimdhënies dhe testimit e vlerësimit si dhe u vë atyre në dispozicion syllabusin respektiv. Kjo procedurë u konfirmua dhe nga studentët në takimin e zhvilluar. Stafi akademik u vë në dispozicion syllabusin e lëndës/modulit si dhe matëriale të tjera mbështetëse. Këto matëriale u vihen në dispozicion studentëve përmes sistemit elektronik, grupeve të ndryshme në rrjete sociale (WhatsApp) ose me email.

Stefan Retaj

lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<i>Takim me stafin akademik;</i> <i>Takim me studentët;</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Vlerësimi i njohurive zhvillohet duke përdorur metoda të ndryshme dhe realizohet nëpërmjet vlerësimit gjithëvjeter (përkatësisht semestral) të punës në auditor, përgatitjes së detyrave të kursit, rezultateve laboratorike, praktikës profesionale dhe provimit përfundimtar. (Ev. 23, Tab21). Përcaktimi i raporteve në mes të vlerësimit të vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimit përfundimtar bëhet nga çdo pedagog dhe paraqitet në programin e lëndës. Stafi akademik dhe studentët konfirmuan këtë procedurë. Pedagogët japin informacione të nevojshme për zhvillimin e lëndës në faqet e internetit të lëndëve/moduleve, si dhe për çdo veprimtari, studentët informohen në mënyrë të veçantë nga pedagogët (Ev. 25, takimi me studentët). Këto praktika sigurojnë një vlerësim të ndjeshëm dhe të plotë të përparimit të studentëve në lëndë, duke inkurajuar angazhimin dhe përgatitjen sistematike gjatë gjithë semestrit.
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Bazuar në dokumentacionin në dispozicion si dhe në takimet me studentët e këtij programi studimi, vihet re se format dhe metodat e mësimdhënies vlerësohen në mënyrë periodike nga studentët nëpërmjet pyetësorëve. Vlerësime që më pas bëhen pjesë e analizës në njësinë bazë dhe nëse gjykojnë, përdoren për përmirësimin në vazhdim të shërbimeve të ofruara nga njësia bazë dhe ajo kryesore për studentët. Kjo praktikë e përfshirjes së studentëve në procesin e përmirësimit të mësimdhënies kontribuon në krijimin e një mjedisi mësimor të përfshirë dhe të orientuar drejt suksesit të studentëve. (Ev. 11).
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në	Në Universitetin Aldent, programi i studimit për "Teknikën laboratorike mjekësore" përmban elemente të shumëllojshme të mësimdhënies për të siguruar rezultate të mira të të nxënit (Ev. 27). Përdorimi i punimeve të personalizuar, detyrave kurse dhe mjeteve në laboratorin e universitetit përmirëson aftësinë e studentëve për të marrë vendime autonome dhe për të përdorur teknologjitë e reja në fushën e tyre të studimit (Vizita në institucion). Këto forma të mësimdhënies jo vetëm që ndihmojnë studentët të kuptojnë më mirë tematikën, por edhe të zhvillojnë marrëdhënie të ngushta me kolegët dhe të punojnë në një ambient bashkëpunues (Ev. 27). Kjo qasje e lirë në mësimdhënie dhe orientimi drejt punës së pavarur dhe

të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	kreativitetit në mësimdhënie përshkruan praktikën mësimore në Universitetin Aldent.			
Konkluzione	<i>Universiteti Aldent ka hartuar rregullore transparente dhe të drejta për testimin dhe vlerësimin e njohurive, duke përfshirë angazhimin gjatë vitit dhe provimin përfundimtar të organizuar nga departamenti.</i> <i>Studentët informohen rregullisht për zhvillimin e lëndës dhe veprimtaritë përkatëse nga pedagogët.</i> <i>Performanca akademike vlerësohet periodikisht përmes pyetësorëve dhe shërbimit të tutoriatit, që siguron një platformë për sugjerime dhe përmirësime.</i> <i>Metodat e shumëllojshme të mësimdhënies, përfshirë ato online, krijojnë një mjedis të fokusuar në suksesin e studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Zhvillimi i provimeve bëhet brenda periudhave të caktuara në strukturën e vitit akademik, si dhe realizohet një kombinim i formave të testimit dhe vlerësimit, përfshirë provimet, projektet dhe aplikimet praktike. Kjo tregon që testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohen gjatë gjithë vitit akademik. Informimi i studentëve në fillim të çdo viti akademik dhe semestri për metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të parashikuar në syllabuset e lëndëve/moduleve si dhe transparenca dhe informimi rreth detyrimeve të tyre në fund të lëndës/modulit, përmbushin kriterin e sigurimit të një procesi transparent dhe të njohur për studentët. (Ev.3.4, 3.6); Takimi me stafin akademik; takimi me studentët;
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme	Institucioni nuk përdor sisteme kontrolli elektronike të automatizuara. Përdorimi i sistemit Moodle është një metodë

Alice Retory

elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	por kjo zhvillohet vetëm për një nivel të ulët kreditesh. UAL përdor sekretimin e provimeve. Kjo platformë përdoret për dërgimin e materialeve didaktike dhe për vlerësimin e detyrave praktike dhe testeve përfundimtare për module me ngarkesë të caktuar kreditesh. Sistemi i monitoruar nga departamenti IT dhe pedagogët e lëndës siguron transparencë dhe shmangien e subjektivitetit në vlerësim, duke lejuar çdo student të logohet me të dhënat personale, të nenshkruajë për prezencën fizike dhe të marrë një test të personalizuar, ndërsa testimi kufizohet në IP-në e auditorit të UAL, për testimet me shkrim, anonimiteti i studentit ruhet duke përdorur barkod të personalizuar, i cili konvertohet në emër nga sekretaria pas korrigjimit të pedagogut të lëndës. Për sa më sipër GVJ u njoh dhe gjatë vizitës në institucion në takimet me studentët. Kriteret e përcaktuara për vlerësimin e lëndës semestrale përfshijnë ndjekjen dhe pjesëmarrjen aktive, plotesimin e detyrimeve, testimet gjatë vitit dhe provimin përfundimtar, ku secili element ka një peshë të caktuar në vlerësimin përfundimtar.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Nota përfundimtare e lëndës përputhet me standardet akademike dhe bazën ligjore të arsimit të lartë në Shqipëri. Përpunimi i notave përbën një proces të qartë dhe të strukturuar, duke u bazuar në elementet e vlerësimit të përcaktuara në syllabus dhe duke respektuar rregullat dhe udhëzimet ligjore. (Ev.27; Syllabuset) Ky proces i vlerësimit siguron një përdorim të drejtë dhe objektiv të kriterëve të caktuar për vlerësimin e përparimit dhe aftësive të studentit në një lëndë të caktuar. Në këtë mënyrë, UAL siguron që notat përfundimtare të lëndës janë të qarta, të besueshme dhe të përputhura me standardet e arsimit të lartë në vend.
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Pedagogët në Universitetin Aldent përdorin komentet dhe këshillat gjatë kontrollit të provimeve për të identifikuar dhe adresuar paqartësitë në procesin e mësimdhënies, si dhe gjithashtu ofrojnë sugjerime dhe udhëzime në faqen e modulit/lëndës në UAL eLearning për të ndihmuar studentët në përmirësimin e dijeve dhe arritjen e objektivave të lëndës.

Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Eferuar RVB-së, Universiteti Aldent, departamenti organizon sesionet e provimeve në përputhje me kalendarin akademik, duke siguruar masa kundër plagjiaturës dhe kopjimit nëpërmjet organizimit të provimeve në ambiente të mjaftueshme dhe mbikëqyrjes së tyre nga dy pedagogë, duke ndaluar përdorimin e burimeve didaktike dhe elektronike, dhe, në disiplina të caktuara, duke vlerësuar studentët bazuar në produktet e tyre praktike. (Ev. 3.4, 3.6)
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rezultatet e provimeve në Universitetin Aldent publikohen brenda një periudhe prej 7 ditësh pas zhvillimit të tyre dhe prezantohen individualisht për secilin student nga pedagogu i modulit. Pas njohjes së vlerësimit, rezultatet vendosen në sistem nga sekretaria mesimore, duke u bazuar në rregulloret përkatëse për shkollën (Ev.3.4. Rregullore e sekretarise, Ev.3.6. Rregullore e provimeve; takimi me studentët).
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Institucioni garanton të drejtat e studentëve për tu njohur me vlerësimin dhe për të kërkuar rishikim të vlerësimit (Takimi me studentët) sipas rregulloreve të përfshira në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Studentët kanë të drejtë të sqarohen për çdo paqartësi dhe të kundërshtojnë rezultatin brenda dy ditëve nga shpallja e tyre, dhe në rast nevojë, ata mund të kërkojnë rishikim të testit nga një komision tjetër, i cili miratohet nga dekani i fakultetit pas analizimit të pretendimeve dhe argumenteve (Ev. 17, 3.2).
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Çdo kërkesë ose ankimim nga studentët shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga një komision i posaçëm, duke u siguruar që procedurat të jenë transparente, të dokumentohen dhe arkivohen. Pas përfundimit të kësaj procedure, nota bëhet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të dokumentojë mbylljen e procesverbalit në sistem dhe në sekretarinë mesimore. Studentët kanë të drejtë të njihen me gabimet dhe të kërkojnë rishikimin e notës, duke drejtuar me shkrim Departamentit, dhe procedura e ankimit përfshin një proces të posaçëm me pjesëmarrjen e pedagogut të modulit dhe studentit. Ky proces dokumentohet në departament, dhe studentët kanë të drejtë të ndjekin hapat e parashikuara për procedurën e ankimit të rezultatit të provimit (Ev. 3.2).
Konkluzione	<i>Procesi i vlerësimit në Universitetin Aldent tregon një koordinim dhe implementim të mirë të kriterieve për testimin dhe vlerësimin e njohurive dhe aftësive profesionale.</i> <i>Duke filluar nga organizimi i provimeve brenda vitit akademik dhe aplikimi i formave të ndryshme të testimit, si dhe sigurimi i transparencës për studentet në lidhje me metodologjinë dhe</i>

	<i>detyrimet e tyre, institucioni demonstroi nje angazhim te qarte per nje proces te drejte dhe te qarte.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi ofrohet në tre vite akademik, ka në total 180 ECTS dhe studentët në përfundim të studimeve fitojnë titullin Teknikë Laboratori Mjekësore. Objektivat dhe kurrikula e Bachelor në Teknikë Laboratori Mjekësore janë përgatitur për t'ju ofruar studentëve njohuri të thella dhe të plotë mbi punën, parimet dhe metodikën e punës në specialitetin e laborantit, në mënyrë që studentët të përfitojnë një formim të plotë duke u aftësuar. Programi i studimit Bsc në Teknikë Laboratori Mjekësor siguron thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve nëpërmjet moduleve të strukturuar që kapin disa drejtime kryesore të diagnostikës dhe terapisë (Ev.24). Përveç kësaj, organizimi i raporteve midis veprimtarive formuese dhe formave të mësimdhënies siguron që studentët të pajisen me njohuri të thelluara dhe aftësi të zhvilluara profesionale për të përshtatur me sukses në ciklin e dytë të studimeve (Ev.27). Gjithashtu, programi ka përputhje me praktikat më të mira evropiane dhe kërkesat shëndetësore të popullsisë, duke reflektuar kështu nevojat dhe trendet e zhvillimit në fushën e laboratorëve mjekësorë.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Programi i studimit siguron zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit përmes moduleve të përfshira si Informatikë Mjekësore, Psikologji, Sociologji, Anglishte profesionale, dhe të tjera, duke ofruar një formim të plotë për studentin si një profesionist me kompetenca të zhvilluara profesionale dhe të komunikimit. Për të thelluar më tej aftësitë e përdorimit të teknologjisë, programi përfshin module për formimin e përgjithshëm, teknologjinë dhe zbatimin e saj në mjekësi, etikën profesionale dhe komunikimin, administrimin e pacientit etj. (Ev. 23. Tab 22). Në të njëjtën kohë, syllabuset

Handwritten signatures: Huse and Retaj

	e lëndëve/modulit prezantojnë përmbajtjen dhe ndarjen sipas veprimtarive formuese, krediteve dhe orëve të duhura, dhe objektivat, aftësitë dhe kompetencat paraqiten në çdo syllabus, duke siguruar kështu një shtrirje të përgjithshme të qëllimeve të programit të studimit.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Personeli akademik analizon dhe shqyrton kompetencat dhe aftësitë e studentit në përfundim të lëndës, duke i orientuar ata për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse, dhe duke integruar të rejat më të fundit të shkencës dhe teknologjisë së informacionit në mësimdhënie. Pedagogu i lëndës rishikon syllabusin çdo vit dhe sugjeron ndryshime për të përmirësuar pritshmëritë e studentëve (Takimi me stafin akademik), duke përdorur bashkëpunimin e vazhdueshëm me ta për të siguruar që njohuritë dhe informacioni të jenë të kuptueshëm dhe të qartë për ta në mënyrë që ata të jenë të përgatitur për aplikimin praktik të tyre. Institucioni organizon leksione të hapura gjatë vitit akademik për të promovuar temat shkencore, teknikat e reja të diagnostikimit dhe trajtimit, si dhe për të promovuar shëndetin dhe aspektet sociale.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të	Mësimdhënia është ndërtuar mbi bazë kompetencash për të zhvilluar njohuritë në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik inkurajon diskutimet dhe punën në grup për zgjidhjen e çështjeve të caktuara dhe krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative dhe kërkimore. Përmes moduleve laboratorike dhe praktikave, studentët përparojnë në shprehjen e aftësive profesionale para se t'i zbatojnë në situata reale. Gjithashtu, ata marrin pjesë në projekte kërkimore dhe shkencore, duke përfutur nga mbështetja e institucionit dhe duke përjetojë një rritje të cilësisë së punimeve të tyre, ndërsa eksperiencat ndërkombëtare, përfshirë dhe ato nga programet ERASMUS, kontribuojnë në qasjen inovative dhe efikase në mësimdhënie (Ev. 10). Studentët e informuan GVJ për eksperiencat e kolegëve të tyre gjatë shkëmbimeve në kuadër të programit ERASMUS.

mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.				
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik organizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë, duke ofruar leksione të hapura për studentët për tematika të ndryshme shëndetësore, si Dita Ndërkombëtare e HIV-AIDS, autizmit, diabetit, etj. Gjithashtu, ata sigurojnë pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete shkencore jashtë vendit, përfshirë shkolla verore dhe dimerore mjekësore, si dhe trajnime multidisiplinare mjekësore, për të përshpejtuar aftësitë dhe njohuritë e tyre në fushën e mjekësisë (Ev. 23).			
Konkluzione	<i>Programi i studimit në Teknikë Laboratori Mjekësor siguron thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve nëpërmjet moduleve të strukturuar dhe përputhjes me praktikat më të mira evropiane dhe kërkesat shëndetësore të popullsisë.</i> <i>Personeli akademik analizon dhe shqyrton kompetencat dhe aftësitë e studentit në përfundim të lëndës, duke përdorur metodat e mësimdhënies inovative dhe duke siguruar një qasje të përshtatshme për zhvillimin e aftësive profesionale.</i> <i>Përveç kësaj, studentët përfshihen në leksione të hapura dhe aktivitete shkencore jashtë vendit, si shkolla verore dhe dimerore mjekësore, për të përshpejtuar aftësitë dhe njohuritë e tyre në fushën e mjekësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i	UAL ka hartuar rregullore të posaçme për diplomimin e studentëve, duke përcaktuar procesin e diplomimit në mënyrë të detajuar, duke përfshirë mënyrat e mbrojtjes së diplomës dhe provimin final (Ev.3.1, takimi me stafin akademik). Ligji për profesionet e rregulluara konfirmon që tekniku i laboratorit është një profesion i rregulluar dhe që e drejta për të ushtruar profesionin merret pas provimit të licensimit. Studentët për këtë program dhe mbrojtja e diplomës realizohet me një fond

Handwritten signature: ALBO ROKU

jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	pyetjesh gjithëpërfshirëse të tipit të quizit të licensimit, si dhe me prezantimin para komisionit (Ev. 18). Kjo demonmontron që institucioni është i përgatitur për të siguruar një proces të rregullt dhe të ligjshëm për diplomimin e studentëve.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Strukturat përgjegjëse, si Fakulteti dhe departamenti, si dhe personeli akademik janë të përfshirë në ndihmën e studentëve për detyrimet përmbyllëse. Ata sigurojnë informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme për provimin final dhe mbrojtjen e diplomës (Takimi me stafin, si dhe takimi me studentët). Pedagogët në departament punojnë ngushtë me studentët, duke i konsultuar ata për çdo paqartësi që mund të kenë në lidhje me mënyrën dhe përmbajtjen e provimit final. Kjo tregon që institucioni është i përkushtuar për të mbështetur studentët në përmbushjen e detyrimeve të tyre përmbyllëse dhe në përgatitjen për provimin final dhe mbrojtjen e diplomës.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Departamenti përgatit pyetje që lidhen me përmbajtjen e lëndës/modulit të zhvilluar dhe pastaj zgjedh pyetjet e nevojshme për provimin final nga një fond i caktuar pyetjesh. Kjo procedurë siguron që provimi final të jetë i përshtatshëm për të vlerësuar njohuritë dhe aftësitë e studentit në mënyrë të plotë dhe objektive. Studentët, një program të tillë e marrin pranë sekretariesë mësimore (Takimi me studentët).
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Studentët në përfundim të këtij program studimi diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar dhe jo me punim diplome. RVB i referohet nenit 73, pikën 2 të Ligjit 80/2015 të arsimit të lartë, si dhe rregulloreve të institucionit. UAL zbaton këtë politikë për të siguruar zhvillimin korrekt të provimeve finale/diplomimit dhe për të ruajtur standardet e përcaktuara (Ev. 17). Plagjiatura, kopjimi, apo forma të tjera të mashtrimit trajtohen me seriozitet dhe ndëshkohen bazuar në parimet themelore të vlerësimit dhe meritës në provime, sipas dokumenteve të institucionit.

Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Politikat e institucionit përcaktojnë mbështetjen dhe orientimin për studentët në kryerjen e matjeve, analizave, dhe testeve për prezantime në konferenca dhe seminare, të cilat janë një mënyrë e mirë për të argumentuar përkushtimin e institucionit ndaj kësaj çështjeje (Takimi me stafin akademik, takimi me studentët). Në këtë mënyrë, UAL i kushton një vlerësim të qartë mbështetjes për studentët në realizimin e projekteve të tyre të kërkimit.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	GVJ u njoh gjatë takimit me stafin akademik, si dhe me studentët mbi procesin e vlerësimit pas përfundimit të provimit përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës. Evidentimi i procesit të korrigjimit të tezave nga komisioni i diplomimit dhe vlerësimi i tyre në pikë, i cili pastaj konvertohet në notë dhe regjistrohet në procesverbale, është një pjesë kritike e procesit të vlerësimit dhe siguron transparencën dhe qartësinë në procedurat e vlerësimit. Kjo siguron një vlerësim të saktë dhe të drejtë të punës së studentit, dhe shënon një përfundim të qartë të procesit të vlerësimit.
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Procesi dhe dokumentacioni që studenti merr në përfundim të studimeve të tyre, përfshin marrjen e diplomes universitare, e cila është e evidenton ciklin dhe emërtimin e diplomes, si dhe suplementin e diplomes. Ky dokumentacion përmban të gjitha elementet akademike dhe është miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, duke u bazuar në udhëzimet dhe rregulloret zyrtare për regjistrimin dhe certifikimin e diplomave. Për më tepër, studentëve u vihet në dispozicion një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, që mund të shfrytëzohet për procese të ndryshme, duke përfshirë njohjen e diplomës për punësim jashtë shtetit ose për të plotësuar kërkesat vendore për njohjen e diplomës. (Ev. 24; 25)
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	RVB përshkruan praktikën e institucionit në ruajtjen dhe mireadministrimin e dokumentacionit të studentit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kjo përfshin ruajtjen e dokumentacionit të studentit për një afat të pacaktuar në përputhje me udhëzimet për arkivat në Republikën e Shqipërisë. Në këtë mënyrë, UAL siguron që dokumentacioni akademik i studentit të ruhet në mënyrë të ligjshme. Gjithashtu, UAL ofron informacione për studentin në rastet kur kërkohet ose lejohet sipas udhëzimeve dhe rregullimeve të institucioneve shtetërore.
Konkluzione	<i>UAL ka të përcaktuar qartë procedurat e mbylljes së studimeve, mbrojtjen e diplomës apo të provimit të formimit.</i>

Handwritten signature: R. K. R. R.

	<i>UAL pajis studentët me diplomën sipas standardit të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, së bashku me suplementin e saj. Ligji për profesionet e rregulluara konfirmon se tekniku i laboratorit është një profesion i rregulluar dhe se e drejta për të ushtruar profesionin merret pas provimit të licensimit.</i> <i>UAL trajton me seriozitet çështjet e plagjiaturës, kopjimit, apo formave të tjera të mashtrimit në provime, bazuar në parimet themelore të vlerësimit dhe meritës në provime.</i> <i>Departamenti ofron ndihmë dhe orientim për studentët në kryerjen e matjeve, analizave dhe testeve për prezantime në konferenca dhe seminare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të	Departamenti përgjegjës për programin e studimit Bachelor në Teknikë Laboratori Mjekësor në Universitetin Aldent është Departamenti i Teknik Laboratori Mjekësor dhe Imazheri (DTLMI). Nga shqyrtimi i dokumentacionit (tab 5-5.3) të dhënat për numrin gradat dhe titujt e pedagogëve, të angazhuar në këtë program studimi, paraqiten si më poshtë: ✓ Në vitin akademik 2021-2022, kanë dhënë mësim në këtë program studimi 31 pedagogë nga të cilët 21 PAE dhe 10 PAK;

Alona Rebo

programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

- ✓ Në vitin akademik 2022-2023, kanë dhënë mësim në këtë program studimi 33 pedagogë nga të cilët 23 PAE dhe 10 PAK;
- ✓ Në vitin akademik 2023-2024, kanë dhënë mësim në këtë program studimi 34 pedagogë nga të cilët 24 PAE dhe 10 PAK;

Tituj/ grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	-	-	-
Prof. Asoc.	2	1	2	2	3	3
Dr./PhD.	7	3	7	3	9	3
SPA	3	4	4	3	3	3
Msc.	6	2	9	2	8	1
Bsc	3	-	1	-	1	-
Totali	21	10	23	10	24	10

Sipas përcaktimeve ligjore (pika 6 neni 59 i Ligjit Nr 80/2015), personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Nga sa më sipër konstatohet se në këtë program studimi Bachelor, angazhohen edhe staf akademik me Bsc (edhe pse numër shumë i vogël).

Të merren masa që të angazhohen në mësimdhënie vetëm personel akademik me të paktën Msc, në përputhshmëri me kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit akademik.

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Ne programin bachelor Teknikë Laboratori Mjekësor janë angazhuar personel akademik efektiv dhe me kontrate, të cilët janë përgjegjës për mbulimin e moduleve/lendeve të programit të studimit, vecanërisht ato të profilit paraklinik dhe klinik dhe që zoterojnë tituj akademik, grada dhe master shkencor. GVJ, pasi shqyrtoi dokumentacionin e vënë në dispozicion lidhur me planet mësimore, ngarkesën mësimore vjetore si edhe CV e stafit, konstatoi se anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontrate që angazhohen në mësimdhënie janë në përputhje të plote me fushën e programit të studimit dhe profilin e lendeve/moduleve që mbulojnë të cilat pasqyrohen qartë edhe në syllabuset e tyre. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV,

	u konstatua se ngarkesa mësimore e personelit akademik për vitin akademik 2023-2024, është si më poshtë vijon: <table><tr><th>Viti</th><th>Total orësh</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE/PAK (%)</th></tr><tr><td>23-24</td><td>3737</td><td>3054</td><td>683</td><td>82% / 18%</td></tr></table> (Ev. 23, tab 5; Ev. 28.1; 28.2)	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	23-24	3737	3054	683	82% / 18%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)							
23-24	3737	3054	683	82% / 18%							
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Bazuar ne dokumentacionin e shqyrtuar ne drejtorine e burimeve njerezore si edhe tabelat e karrieres akademike dhe shkencore, ne raportet vjetore te departamentit ku zhvillohet programi i studimit, CV e stafit, GVJ konkludon se ka qendrueshmeri dhe progres te personelit akademik fale edhe mbeshtetjes institucionale te promovimit te tij. Mbeshtetja logjistike, shendetsore dhe sociale reflektohet ne permbushjen e detyrimeve kontraktuale pasi nje pjese e stafit akademik kryesisht staf me kontrate jane njekohesisht pjese e stafit mjeksor te QSUNT apo qendrave te tjera shendetsore ne bashkepunim me UAL. (Ev. 28) Gjithashtu, nga kontrolli i kontratave te punes dhe respektimit te praktikave te punesimit u konstatua se jane paguar rregullisht sigurimet shoqërore dhe shëndetësore publike. Gjithashtu, institucioni i ka siguruar falas stafit, karte siguracioni privat nepermjet te ciles behen te mundur ekzaminime dhe vizita falas 1 here ne vit dhe ulje te cmimit per keto sherbime gjate gjithë vitit. (Ev. 5)										
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Gjate vizites ne institucion me perfaqesues te Zyres se Burimeve Njerezore si edhe shqyrtimit te evidencave te Raportit te Vleresimit te Brendshem, GVJ u informua mbi proceduren dhe praktiken e punesimit te personelit akademik, ndihmes/akademik dhe administrativ, me modelin e kontratave te punes dhe gjithashtu verifikoi permbajtjen e dosjes se PAE dhe PAK (Vizita institucionale). Gjate ketij verifikimi dosja permbante konkretisht dokumentacionin e meposhtem: • Formatin europass te CV • Fotokopje e pasaportes ose ID, adresen e banimit • Formular vetedeklarimi/Deshmi penaliteti, Pozicioni i punes • Diplomat e noterizuara me listat e notave perkatese: Bachelor, Master, Doktorature, Specializim, Deshmi Titulli Shkencor. • Kualifikimet • Librezen e punes										

	Dosjet perditesohen periodikisht ne fillim te cdo viti akademik (Ev. 3.7). Institucioni disponon nje procedure te rekrutimit dhe punesimit te PAE/PAK bazuar ne Kodin e Punes te Republikes se Shqiperise, akteve ligjore dhe nenligjore te arsimit te larte, Statutit dhe Rregullores se UAL. (Ev. 4) Punesimi realizohet me procedure te konkurimit te hapur duke garantuar nje proces transparent ne perputhje me kerkesat dhe kriteret e percaktuara ne statutin dhe rregulloren e institucionit. Cdo vit departamentet percaktojne ngarkesen mesimore, planifikimin e personelit qe perfshihet ne programin e studimit dhe nevojat per staf akademik nese ka, te cilat i paraqiten dekanatit qe ia percjell rektoratit dhe me pas kalojne per miratim ne senat. Pas miratimit njesia kryesore ben shpalljen publike te pozicioneve te punes per PAE/PAK duke e publikuar njoftimin ne faqen web te UAL. Kandidatet informohen nepermjet faqes zyrtare te njesise kryesore per kriteret e pergjithshme dhe specifike te punesimit, dokumentacionin e nevojshem, afatet kohore si edhe tabelen e pikezimit. Pas perfundimit te afatit te dorezimit te dokumentacionit, drejtuesi i njesise kryesore ka ngritur komisionin ad/hoc per perzgjedhjen e kandidateve fitues. Komisioni ad/hoc ka kryer vleresimin e kandidateve nepermjet shqyrtimit te dokumenteve/dosjes sipas nje sistemi pikezimi te miratuar me pare nga senati akademik. Kur procedura mbyllet, vendimi i komisionit i eshte percjelle per miratim titullarit te njesise kryesore dhe senatit akademik. Punemarresi dhe punedhenesi kane lidhur kontraten e punes ne baze te legjislacionit ne fuqi dhe kodit te punes. (Ev. 4) Performanca e stafit akademik vleresohet jo vetem ne momentin e rekrutimit por vazhdimisht nepermjet pyetesoreve te studenteve dhe formuleve te vleresimit te pedagogut. (Ev. 4.1; 11)
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve	Gjate vizites ne institucion dhe shqyrtimit te dokumentacionit GVJ evidentoi angazhimin e personelit ndihmes akademik te cilet asistojne ne realizimin e orëve laboratorike dhe kujdesen per mirëmbajtjen e laboratorëve te programit te studimit Bachelor Teknik Laboratori (Ev. 23). Per rekrutimin e tyre ndiqet e njejta procedure e pershkruar ne kriterin 4 (Ev. 3.7). Praktikat laboratorike zhvillohen ne mjediset laboratorike te Universitetit Aldent te dedikuar per kete program studimi (Ev 17, rregullore e programit neni 8 pika 3), kurse praktikat profesionale zhvillohen ne laboratoret profesionale sipas

të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	marreveshjeve me palet e treta, kryesisht QSUNT. (Ev. 19; ev shtese 7 marreveshje me QSUNT). Personeli ndihmes akademik dhe ai me kohe te pjesshme qe angazhohen ne veprimtarine mesimore eshte i mjaftueshem, eshte i profilit teknik laborator i dhe zoteron te gjitha kualifikimet dhe kompetencat per realizimin me cilesi te oreve laboratorike (Ev. 28.1; 28.2)
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarë në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Gjate takimit me perfaqesues te Drejtorise se Burimeve Njerezore ne viziten institucionale si edhe bazuar ne shqyrtimin e dokumentacionit te vene ne dispozicion, GVJ konstatoi se UAL nepermjet kesaj drejtorie disponon, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit akademik, ndihmes akademik dhe administrativ të angazhuar në programin e studimit Bachelor Teknik Laboratori te FSHMT, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Te dhenat qe lidhen me aktivitetin dhe ngarkesen mesimore, aktivitetin kerkimor shkencor dhe te cdo angazhimi tjeter te stafit akademik perdoren per tu pasqyruar ne analiza dhe raporte vjetore te departamentit (Ev shtese 31 raport vjetor FSHMT) dhe drejtorise se burimeve njerezore ne kuader te vleresimit te performances dhe vetvleresimit ne procese te ndryshme (Ev. 8; 22). Zyra e Burimeve njerezore disponon dosjet personale te stafit akademik se bashku me marreveshjet e realizimit te ngarkeses mesimore si edhe dosjet personale te stafit jo akademik. (Ev. 3.7) Te dhenat ruhen ne rregjistrin themeltar te stafit por edhe elektronikisht te cilat perditesohen cdo vit nga Zyra e Burimeve Njerezore perfshire ketu edhe ndryshimet e vendit te punes nese ka apo terheqjen e librezes se punes nga individi (Vizita institucionale). Nepermjet dokumentacionit te vene ne dispozicion, GVJ u njoh me te dhenat tabelare te personelit akademik efektiv dhe me kontrate, ngarkesen e tyre mesimore në çdo semester/vit akademik dhe kualifikimin perkates (Ev. 23, tab 3)..
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të	Gjate vizites ne institucion, GVJ verifikoi se FSHMT ne Universitetin Aldent disponon laboratore te dedikuar per zhvillimin e praktikave laboratorike per programin e Teknik Laboratori te mirembajtura dhe te mirepajisura ne te cilat angazhohen personel akademik te profilit Teknik Laboratori me eksperience disa vjecare ne fushen e laboratorit (Ev. 20). Gjithashtu, GVJ evidentoi se FSHMT dhe UAL ka lidhur marreveshje bashkepunimi me QSUNT, ISHP, Genius SHPK, Intermedica, Qendren Kombetare te Transfuzionit te Gjakut

kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	dhe institucione të tjera për realizimin e praktikës laboratorike të programit Teknik Laboratori (Ev. 19; Ev. shtese 7 marreveshje me QSUNT). Marreveshjet kanë si qëllim jo vetëm realizimin e praktikave profesionale por edhe zhvillimin e studimeve kerkimore të studentëve, punimin e diplomave, njohjen e tregut të punës dhe krijimin e lidhjeve për mundësi punësimi në të ardhmen. Mbikqyresit e praktikave profesionale janë njëkohësisht edhe personel shëndetsor në këto laboratore.			
Kriteri 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Institucioni ka një procedurë të mirëpërcaktuar që koordinohet nga përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me dekanatin dhe titullarin e lëndës për shpërndarjen e praktikës profesionale në baza të marrëveshjeve me institucionet pritëse duke angazhuar personelin e atij shërbimi si mbikqyrës i praktikës profesionale. Mbikqyresit e praktikave në mjediste spitalore të angazhuar si staf akademik me kohë të pjesshme bashkëpunojnë ngushtë me stafin akademik efektiv sipas shërbimeve klinike perkatese. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe marrin pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale (Ev. 18; Ev shtese 17).			
Konkluzione	<i>Personeli akademik që mbulon programin e studimit BSc. Teknikë Laboratori Mjekësor përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit. Konstatohet një % shumë e vogël e stafit mësimdhënës me Bsc, (2.9 %), të merren masa që të angazhohen në mësimdhënie vetëm personel akademik me të paktën Msc, në përputhshmëri me kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit akademik.</i> <i>Në këtë program studimi personeli akademik efektiv mbulon 70% të ngarkesës mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</i> <i>Institucioni disponon laboratore të dedikuara për zhvillimin e praktikave laboratorike dhe ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione shëndetsore për realizimin e praktikës profesionale, të konstatuara nga GVJ që janë aktive.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	GVJ ka vizituar kampusin universitar ALDENT me mjediset mesimore dhe infrastrukturën moderne në shërbim të mesimdhënies dhe aktivitetit shkencor, mjedisin e bibliotekës, shërbimit të teknologjisë së informacionit, si edhe zyrat e administratës dhe personelit akademik në mbështetje të veprimtarisë mesimore dhe shërbimit ndaj studentëve. Aktiviteti mesimor për programin Teknik Laboratori zhvillohet kryesisht në korpusin e ri universitar Aldent në një infrastrukturë të përshtatshme dhe në përmbushje të standarteve për zhvillimin e një procesi mesimor cilësor (Vizita institucionale). Gjate shqyrtimit të dokumentacionit GVJ u njoh me të dhënat për zhvillimin e infrastrukturës, investimet, planimetritë dhe sipërfaqet në funksion të procesit akademik, stafit dhe studentëve (Ev. 13.1). GVJ konstatoi se Universiteti Aldent ka në dispozicion të procesit mesimor një sipërfaqe prej 8500 m² dhe një ambient parkimi prej 2500 m². Korpusi i ri universitar ka 2 godina C+D, i përbërë nga 28 salla leksioni dhe seminari me kapacitet 40–120 studente dhe 24 laboratore të pajisura me të gjitha mjetet në funksion të programeve të studimit si laboratorët e anatomisë, kimisë, mikrobiologjisë, laboratorët klinikobiotikë etj. Universiteti Aldent ka në dispozicion salla leksioni me kapacitet të tilla që mundësojnë zhvillimin e konferencave, workshop-eve, leksioneve të hapura etj. Institucioni disponon 1 bibliotekë që shtrihet në një hapësirë prej 430 m² si dhe salla leximi të mjaftueshme ku mundësohet akses i internetit. Universiteti Aldent disponon gjithashtu zyrën e informacionit për studentët, zyrën e shërbimit informatik IT, si edhe arkivën. Organizimi i orarit mesimor realizohet në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse (Takimi me drejtuesin e departamentit dhe stafin).
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të	Gjate shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion GVJ konstaton se mjediset mësimore të Universitetit Aldent, si një universitet me profil teresisht mjekësor, janë të mjaftueshme dhe garantojnë realizimin e procesit mesimor



pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	teorik dhe praktik duke marre ne konsiderate jo vetem kapacitetet e posteve ne raport me numrin e studenteve por edhe mjetet didaktike dhe te kancelarise ne funksion te procesit mesimor (Ev. 23). Sallat e leksioneve jane te pajisura me te gjitha mjetet teknologjike bashkëkohore ne funksion te mesimdhënies si PC, videoprojektore, tabela, mikrofone etj dhe ne sherbim te stafit akademik dhe administrativ jane ne dispozicion edhe projektore portabel dhe mjete kancelarie. Mjediset e institucionit kane nyje hidrosanitare te mjaftueshme per numrin e studenteve, sistem te mbrojtjes kunder zjarrit te cilat u konstatuan edhe gjate vizites ne institucion. Ndricimi natyral dhe artificial eshte i mjaftueshem per realizimin e aktivitetit akademik dhe sigurohet energji pa nderprerje. Institucioni disponon system qendror kondicionimi. (Vizita ne institucion).
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimi teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Universiteti Aldent disponon laboratorë, studio, apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, te pajisura me aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për veprimtarine mesimore te cilat jane asete te vlefshme dhe investim i madh ne sherbim te studenteve dhe stafit akademik (Ev. 20, 21). Ne funksion te programit te studimit, jane laboratorit i anatomise, histologjise dhe anatomise patologjike, laboratorit klinik, laboratorit mikrobiologjik/imunologjik (Ev. 20). GVJ vizitoi mjediset e laboratoreve te cilat ishin te pajisura me te gjitha mjetet e nevojshme per aftesimin praktik te studenteve sipas natyres specifike te programit dhe llojit te laboratorit si manikine/mulazhe per anatomine, pajisje te dedikuara per histologjine, pajisje per ekzaminime laboratorike si mikroskop, laminara, spektrofotometer, urinometer, rotator, centrifuge, autoklav, laminare, termostate, cell counter, banjomari, detector ELISA, etj. (Ev. 21, vizita ne institucion). Studentet aftesohen te kryejne teknika te ndryshme ne kushte te sigurta si edhe te dokumentojne te dhenat laboratorike
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale	FSHMT ne Universitetin Aldent disponon nje laborator të teknologjisë së informacionit ne funksion edhe të këtij programi dhe i dedikuar vecanerisht per lenden e informatikes, statistikes dhe kerkimit shkencor. Ky laborator eshte i aksesueshem me nje database literature elektronike e perditësuar me materiale te viteve te fundit. Institucioni ka permiresuar vazhdimisht infrastrukturen laboratorike

[Signature]

sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	nepermjet investimit të drejtperdrejt sipas kërkesave të departamentit (Ev. 23).			
Konkluzione	<i>Institucioni siguron mjedise mësimore dhe infrastrukture moderne dhe të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik të studenteve.</i> <i>Universiteti Aldent zoteron laboratore të dedikuara për programin Bachelor Teknikë Laboratori Mjekësor që përmbajnë aparatura dhe mjete të nevojshme për aftësimin praktik të studenteve sipas natyrës specifike të programit.</i> <i>Ne funksion të programit të studimit është laboratori i teknologjise së informacionit i dedikuar vecanerisht për lenden e informatikes, statistikes dhe kerkimit shkencor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	FSHMT në UAL siguron literaturë bazë dhe ndihmëse në dispozicion të studentëve në programin e studimit Bachelor Teknikë Laboratori Mjekësor, qoftë si fond fizik, qoftë duke aksesuar bibliotekën dixhitale në mbështetje të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Studenteve u rekomandohet gjithashtu ndjekja e revistave apo aksesimi online i teksteve. Kjo u konstatua edhe gjatë takimit me studentet dhe stafin në viziten institucionale. Në disa raste pedagogët u referojnë studenteve si literature baze leksione të printuara si cikël leksionesh ose i ngarkojnë në faqen e modulit në platformën UAL eLearning (Ev. 27.1/2/3; Ev. shtese 18 Nderfaqe të platformës UAL-LMS). Per përgatitjen e leksioneve, stafi akademik shfrytëzon literature dhe libra nga autore dhe shtëpi botuese të njohura si Elsevier, gjë që u konstatua nga GJV gjatë shqyrtimit të syllabuseve dhe vizites në bibliotekën e universitetit (Ev. 26, vizita në institucion). Biblioteka disponon fond fizik dhe elektronik të librave mësimore, poste interneti dhe kompjutera

	qe i mundesojne studenteve dhe pedagogeve shfrytezimin e literatures ne mbeshtetje te procesit mesimor. Gjate takimit me stafin ne viziten institucionale por edhe nga dokumentacioni ne dispozicion GVJ konfirmoi se nderveprimi i studenteve me pedagogun e lendes ne periudhen e pandemise u realizua nepermjet platformes elektronike te UAL, google classroom etj.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Ne takimin me pergjegjesit e departamenteve, u deklarua se cdo fillim viti akademik ne mbledhjen e departamentit kerkohet prej pedagogeve perditesimi i literatures me botime te 5 viteve te fundit, i cili duhet pasqyruar ne syllabuset e lendeve. Titullari i lendes dorezon ne njësine përgjegjëse syllabusin e lendes ku jepet informacioni mbi literaturen e detyruar baze dhe te rekomanduar. Gjatë shqyrtimit te syllabuseve dhe kurrikules, GVJ evidentoi se literatura baze e detyruar ishte e perditesuar me botime te 5 viteve te fundit, por ne disa syllabuse ajo nuk citohet si reference bibliografike. Aksesimi online ose ne biblioteken dixhitale si edhe literatura e rekomanduar ne syllabuse permbush gjithashtu standartin per botime te viteve te fundit (Ev. 27.1/2/3; Ev. 26). Ne takimin me punonjesin e bibliotekes GVJ u informua se stafi i FSHMT porositi per biblioteken libra te rinj te botuar vitet e fundit (Ev. 12 Biblioteka, librat e rinj).
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	UAL disponon nje biblioteke qendrore universitare me botime te mjeksise shqiptare por edhe te huaja nga shtepi botuese te njohura ne bote si nje trashegimi e vyer qe perditesohet ne menyre periodike. Ne biblioteken qendrore ruhet nje numer i madh vellimesh te librave mjeksore, botimeve shkencore, teksteve mesimore te personelit akademik, disertacioneve te mbrojtura ne UAL. Keto te fundit jane edhe ne versionin elektronik te cilat mund te aksesohen lehtesisht nga cilido i interesuar (Ev. 12). Biblioteka e Uniuersitetit Aldent funksionon ne perputhje me nenin 30, të Ligjit Nr. 8576, datë 03.02.2000, “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë” dhe disponon nje rregullore te brendshme. Gjate vizites institucionale GVJ evidentoi se biblioteka e UAL permban salla leximi me hapësire te bollshme dhe te dedikuar per studentet duke u garantuar atyre mundesi te barabarta te shfrytezimit te literatures pavaresisht nga fusha qe studjojne. (Ev. Shtese 12 Katalog Aldent; Vizita ne institucion).
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me	Gjate vizites se ambjenteve ne institucion, GVJ evidentoi se Biblioteka e Universitetit Aldent eshte e pajisur jo vetem me

fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	fond fizik si tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore, por ajo disponon gjithashtu edhe katalogun elektronik të bibliotekës, i cili aksesohet online në faqen kryesore të UAL. Kërkimi elektronik kryhet duke kërkuar titujt në bazë të emrit, autorit, apo vitit të botimit. Ne takimin me punonjesen e bibliotekës dhe gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me menaxhimin e bibliotekës, GJVJ u informua se në dispozicion të studentëve janë 10 mijë tituj dhe 16 mijë libra që pasurohen në mënyrë periodike dhe janë të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve dhe veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programeve të studimit. Sallat e leximit dhe të teknologjisë kanë kapacitet rreth 75 poste leximi dhe 50 poste internet të pajisura me kompjuter (Ev. 12 Biblioteka dhe menaxhimi i saj).
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Studentet e FSHMT/UAL kanë akses falas në bibliotekën fizike dhe online të institucionit në funksion të programit mësimor. Ne takimin me studentet në viziten institucionale GJVJ u informua se biblioteka fizike dhe online e UAL shfrytëzohet në mënyrë të barabartë dhe pa pagesë edhe nga studentet e fushës së teknik laboratorit. Bazuar në dokumentacion, UAL në bashkëpunim me MASR është pjesë e ULIBRARY të vënë në dispozicion nga RASH ku studentët dhe personeli akademik mund të gjejnë dhe aksesojnë literaturën e dëshiruar nga salla e bibliotekës por mund ta aksesojnë atë online në çdo kohë. Studentet kanë akses gjithashtu edhe në librari të tjera online si: Hinari, cobiss.net, research4life.org etj. (Ev. 23, tabela 8, 20).
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka e UAL është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët, fakt që u evidentua nga grupi i GJVJ në viziten institucionale. Gjithashtu biblioteka disponon skedare të dixhitalizuara dhe shkëmbim informacioni me biblioteka të tjera brenda dhe jashtë vendit. Kërkimi i informacionit sigurohet nepermjet kompjuterave në sallën e leximit dhe aksesit të pakufizuar të internetit (Ev. 23, tabela 8, 16)
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e	Biblioteka e UAL është në dispozicion të studentëve për literaturë bazë dhe suplementare, fizike dhe on-line. Ajo funksionon dhe organizohet sipas rregullores së brendshme të bibliotekës. GJVJ konstatoi gjatë vizites institucionale se orari i shërbimit të bibliotekës është i përshtatshëm me oraret e

Ala Retaj

zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	programit të studimit dhe nevojave të studenteve. Biblioteka ka qene ne dispozicion te stafit dhe studenteve edhe gjate periudhes se pandemise Covid 19 duke respektuar protokollet e sigurisete aprovuara nga institucionet shteterore. UAL ka punonjes te vecante per biblioteken ne sherbim te mirembajtjes dhe nevojave te studenteve. (Ev. 12 Biblioteka dhe menaxhimi i saj).
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	FSHMT/UAL planifikon cdo vit buxhet për pasurimin e fondit fizik të bibliotekës dhe vitet e fundit sidomos pas periudhës së pandemisë ka rritur investimet për përmirsimin e infrastrukturës elektronike të bibliotekës. Departamentet propozojnë kërkesat buxhetore për pasurimin e fondit fizik dhe online të bibliotekës. Bazuar në këto kërkesa Biblioteka i drejtohet administratorit të UAL për sigurimin e botimeve të reja dhe aksesin në libraritë online nepermjet abonimit. Gjate bisedes me studentet dhe stafin në viziten institucionale u deklarua prej tyre se ata shfrytëzojnë në mënyrë të krenarshme vecanerisht informacionin dixhital si edhe atë fizik të bibliotekës. Në shërbim të tyre ka punonjes të specializuar në bibliotekoekonomi që ruajnë dhe dokumentojnë me profesionalizëm librat e bibliotekës (Ev. shtese 25, procedure e hartimit të projektbuxhetit; Ev. 12 librat e rinj).
Konkluzione	<i>Në syllabuset e lëndëve janë vendosur literatura bazë dhe ajo ndihmëse. Biblioteka e institucionit është e aksesueshme dhe për studentët e programit Bsc Teknikë Laboratori Mjekësor. UAL ka siguruar kapacitetet infrastrukturore të mjaftueshme në bibliotekë, që ofron akses fizik për studentët.</i> <i>Literatura bazë e detyruar është e perditesuar me botime të 5 viteve të fundit, por në disa syllabuse ajo nuk citohet si reference bibliografike.</i> <i>Institucioni siguron shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekën fizike dhe online të fushës së programit të studimit. Orari i shërbimit të bibliotekës është i pershtatshëm me oraret e programit të studimit dhe nevojave të studenteve.</i>

Alon Retaj

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UAL disponon sistem të dedikuar të menaxhimit të të dhënave të studentëve, informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, sistemin FxEducation. Institucioni disponon manualin e përdorimit të sistemit FxEducation. Sipas këtij manuali në Modulin Education përfshihen sekretaria mesimore, bashkëpunimi sekretari/pedagog, sekretari mesimore/departament, pedagog/student, sekretari student. (Ev. 7).
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Institucioni ka dokumentacion të plotë lidhur me aktivitetin e personelit akademik, ndihmës/akademik dhe administrativ të angazhuar në realizimin e programit të studimit. Gjatë vizitës në institucion por edhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ verifikoi se institucioni ka sistem të brendshëm të menaxhimit të të dhënave dhe informacionit, të cilat aksesohen nga stafi dhe studentet (Ev. 7 Manual FxEducation; Ev. Shtese 18 Nderfaqe të platformes UAL-LMS).
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Në regjistrat e sekretarise por edhe tashmë në sistemin e brendshëm FxEducation mundësohet menaxhimi i detyrimeve akademike të studentëve, administrohen dhe ruhen të dhëna, informacione dhe dokumentacione të studentëve që ndjekin studimet, rezultatet e tyre gjatë viteve të studimit si edhe të dhëna për stafin akademik, ndihmës/akademik, administrativ, programet e studimit kurrikular (Takimi me sekretarinë në institucion). Sistemi i menaxhimit siguron akses për studentet, të cilët logojnë me të dhënat e tyre personale për të marrë informacionin që u nevojitet. Studentet përdorin "portalin e studentit" në faqen zyrtare të UAL për tu futur në sistemin FxEducation si edhe për tu regjistruar online në provime (Ev. shtese 18 Nderfaqe të platformes UAL- LMS).

Handwritten signatures: "Alsu" and "Retyu"

	Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për koordinatore të programeve vetëm në programin që ata koordinojnë.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë formë të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Përveç sistemit FxEducation, Universiteti Aldent disponon platformën online UAL-LMS e cila përfshin edukimin në distancë, programet e studimit, modulet e programeve, aktivitetet e një moduli, njoftimet për aktivitete si leksione, provime, rezultatet e provimit, aktivitetin administrativ të UAL, takime periodike online të stafit etj. Pra, kjo platformë është një sistem multifunksional që menaxhon jo vetëm aktivitetin akademik, mësimor por edhe atë trajnues vecanërisht trajnimin dhe edukimin në distancë për të gjithë profesionistët e shëndetit (Ev. shtese 18 Nderfaqe të platformes UAL- LMS).
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Bazuar në manualin e FxEducation, GVJ evidentoi se në sistemin e menaxhimit kanë llogari sekretaria mësimore dhe autoritetet drejtuese duke krijuar mundësi të monitorimit në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ por gjithashtu mundësi për raportime dhe të dhëna për organet drejtuese (Ev.7 Manual FxEducation). Gjithashtu informacioni mundësohet edhe nëpërmjet faqes zyrtare të UAL, të cilat pasqyrojnë veprimtarinë administrative, institucionale, zgjedhjet, programin e transparencës, akademike, kulturore e sociale, ciklet dhe programet e studimit, disertacionet e doktoratave të mbrojtura etj. UAL ka llogari të posaçme dhe përdor shërbimet e ASCAL Management System [AMS] nëpërmjet të cilit UAL administron dhe menaxhon të gjithë informacionin dhe arkivin elektronik që lidhet me të dhënat e institucionit, strukturën akademike, administrative dhe shërbimeve, programet e studimit dhe të dhënat e detajuara për to, studentët aktivë që ndjekin studimet, stafin akademik në kohë reale, fushën e studimit, kualifikimet dhe të dhëna të tjera të cilat përditësohen dhe raportohen në mënyrë të vazhdueshme (www.ascal.al/apps/hei.php). Përveç sistemeve të sipërpermendura, forma të komunikimit interaktiv janë edhe përdorimi i e-maileve zyrtare të institucionit, aksesimi i sistemit UALeLearning që siguron informacion në kohë reale të materialeve në modulet e programit që frekuenton studenti (Ev. shtese 18 Nderfaqe të platformes UAL- LMS)..
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e	Institucioni disponon faqen zyrtare http://ual.edu.al/ në të cilën pasqyrohen aktivitetet në nivel njësie kryesore dhe



studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	perditesohen periodikisht aktivitetet e organizuara nga departamentet dhe stafi akademik, programi mesimor, struktura e vitit akademik, orari mesimor etj. Nepermjet kesaj faqe zyrtare studentet, partneret dhe gjithë te interesuarit informohen në lidhje me thirrje, njoftime, kërkesa apo mundësi të ndryshme që ofrohen nga institucioni. GVJ evidentoi se faqja e universitetit eshte e lidhur me platformen eLearning dhe portalin e studentit, te cilet sic e kemi pershkruar ne kriterin 2 dhe 3, aksesohen nga studentet per marrjen e informacionit ne lidhje me modulet e programit (Ev. shtese 18 Nderfaqe te platformes UAL- LMS). Faqja zyrtare ne web eshte ne gjuhen shqipe dhe angleze.			
Konkluzione	<i>UAL disponon sistem të dedikuar të menaxhimit të të dhenave të studenteve, informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, systemin FxEducation.</i> <i>Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin akademik, sekretarine mesimore, autoritetet drejtuese dhe studentët e programit të studimit.</i> <i>Sistemi i menaxhimit ka të integruar platformen platformen online UAL-LMS që mundëson komunikim interaktiv dhe shkëmbim të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</i> <i>Ne sistemin e menaxhimit kane llogari sekretaria mesimore dhe autoritetet drejtuese duke krijuar mundesine e monitorimit ne kohe reale te aktivitetit akademik dhe administrativ por gjithashtu mundesi per raportime dhe te dhena per organet drejtuese.</i> <i>Institucioni disponon faqen zyrtare http://ual.edu.al/ në të cilën pasqyrohen aktivitetet në nivel njësie kryesore ne dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Handwritten signatures:

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Rektorati ne Universitetin Aldent harton cdo vit akademik Raportin Vjetor i cili eshte dokumentacioni kryesor permbledhes i analizes vjetore te veprimtarisë akademike, shkencore dhe financiare te cdo njesie kryesore dhe strukturave te tjera te UAL. Per hartimin e Raportit Vjetor të institucionit ngrihet nje grup pune i perbere nga përfaqësues te strukturave të ndryshme përfshirë dhe ato të menaxhimit financiar (Ev. shtese 34 Raporti vjetor institucional). Ky raport diskutohet ne nje mbledhje te hapur te Bordit te Administrimit dhe miratohet ne Senatin Akademik (Ev. shtese 22 Praktika per miratimin e buxhetit vjetor). Ne UAL fondet për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi jane kompetence e institucionit por miratohen nga Bordi i Administrimit dhe burojne nga te ardhurat e universitetit prej studenteve, sherbimeve projekteve, i cili vetfinancon te gjitha shpenzimet. Hartimi i buxhetit financiar bazohet ne kerkesat buxhetore te planifikuara ne fillim te cdo viti akademik nga njesite kryesore (Ev. shtese 22, 25).
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Institucioni disponon nje procedure te hartimit te projektbuxhetit qe permban planifikimin e kostove dhe mbeshtetjes financiare per zhvillimin normal te procesit mesimor, buxhetimin, kontabilizimin dhe raportin vjetor (Ev. shtese 25 Procedura e hartimit te projekt buxhetit). Plani i financimit perfshin financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit si psh praktikat spitalore, kostot e auditeve te brendshme etj. (Ev. 23, tabela 19).



Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Bazuar ne RVB dhe dokumentacion, GVJ evidentoi se struktura përgjegjëse për auditimin e brendshëm e ngritur nga UAL është Njësia e Auditit të Brendshëm [NjAB], e cila ushtron veprimtari të pavarur, siguron zbatimin e duhur dhe respektimin e kërkesave ligjore, politikave etj., siguron vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të procedurave të kontrollit të brendshëm. GVJ konstatoi se veprimtaria financiare e institucionit dokumentohet ne raportin vjetor institucional dhe raportin vjetor te NJSBC (Ev. 8, Ev. Shtese 34).
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Institucioni informon dhe raporton njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit, mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. Ky informim realizohet jo vetem me hartimin e Raportit Vjetor te UAL por edhe nepermjet sistemit të menaxhimit qe mundeson raportimin në kohë reale për veprimtaritë që kryhen nga njësite respektive. Nepermjet shqyrtimit te dokumentacionit, GVJ evidentoi jo vetem shpenzimet financiare ne baze te kerkesave dhe planifikimit qe ben cdo departament ne mbeshtetje te veprimtarise akademike por edhe te ardhurat financiare nga tarifat e regjistrimit, shkollimit te studenteve (Ev. shtese 34 Raporti vjetor institucional).
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Institucioni garanton qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Keto kapacitete bazohen ne te ardhurat qe sigurohen nga tarifat e shkollimit dhe te regjistrimit te studenteve. Mireadministrimi i tyre dhe hartimi i plan masave per permiresimin e problematikave te gjetura kane ruajtur stabilitetin financiar te universitetit dhe kane bere te mundur realizimin e investimeve ne infrastrukture dhe logjistike, madje edhe ne kohe krize per shkak te pandemise. GVJ konstatoi se bilancet vjetore te UAL jane transparente dhe behen publike. (Ev. shtese 34 Raporti vjetor institucional).
Konkluzione	<i>Universiteti Aldent harton cdo vit akademik një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme</i>

	<i>për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</i> <i>Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</i> <i>UAL harton cdo vit akademik buxhetin ne baze te kerkesave dhe planifikimeve te departamenteve, i cili miratohet nga Bordi i Administrimit.</i> <i>Institucioni garanton qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programeve të studimit bazuar ne te ardhurat qe siguron nga tarifat e shkollimit, dhe regjistrimit te studenteve te cilat jane mireadministruar duke bere te mundur investimet ne infrastrukture dhe logjistike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Universiteti Aldent dhe Fakulteti i Shkencave Mjeksores Teknike kane hartuar Statut dhe Rregullore në përputhje me legjislacionin në fuqi ne te cilat pershkruhen qarte politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Bazuar ne Statutin e UAL, Rregulloren e FSHMT, Rregulloren e Departamentit qe mbulon programin e Teknik Laboratori Mjekësor, GVJ evidentoi se FSHMT zbaton politika te pranimit te studenteve duke respektuar kriteret bazë të pranimit, kriteret përzgjedhëse, kuotat e planifikuara për kandidatët vendas, kandidatët nga vende shqip folëse; për kategoritë e marginalizuara etj. Gjithashtu ne keto dokumente

Handwritten signature: H. R. R. R.

	percaktohen qarte procedurat e transferimit te studimeve dhe ndjekjes se programeve te dyta (Ev. 1, Ev. 3.2, Ev. 17). Në funksion të informimit të studenteve nga rregjistrimi në diplomim janë në dispozicion sekretaritë mësimore në nivel departamenti dhe fakulteti, zyra e keshillimit te karrieres, koordinatori mesimor qe menaxhon aktivitetin akademik si edhe tutori akademik ne cdo grup mesimor (Ev.3.9 Rregullore e Tutoriatit Akademik.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	UAL dhe FSHMT siguron mundesi te barabarta për të gjithë kandidatët për student sipas programeve te studimit. Bazuar ne dokumentacion, GVJ evidentoi se pranimet e kandidateve per student ne UAL realizohen ne perputhje me kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së studentëve të rinj te cilat bazohen ne VKM dhe Udhezimet e perbashketa te MAS dhe QSHA. Aplikimi behet ne UAlbania sipas kriterave te percaktuara dhe sekretarite e UAL shkarkojne listat dhe bejne renditjen sipas kriterave specifike (Ev. Shtese 20 Pikezimi dhe renditja e aplikanteve). Aplikantet fitues regjistrohen vetem ne nje program studimi dhe dorezojne ne sekretari dokumentacionin e nevojshem i cili nenshkruhet ne regjistra te vecante. Pas nenshkrimit ne regjister behet regjistrimi online ne portalin UAlbania (Ev. 6 Kontrate studenti). Studentet e programit te studimit kane mundesi te njejta per informim, kandidim ne forume drejtuese, konkurim per bursa, pjesemarrje ne mobilitete ne kuader te projekteve Erasmus apo pjesemarrje ne aktivite te ndryshme promocionale. Perzgjedhja realizohet me procedura transparente dhe meritokraci (Ev. 6.1 Politikat e mbështetjes së studentëve; Ev. 10; Ev. 3.5).
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret	Përpara çdo viti akademik, pas kerkeses dhe udhezimeve te MAS, Departamenti propozon dhe percakton numrin e kuotave dhe kriteret specifike për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve, të cilat miratohen në Senat dhe më pas nga MAS. i gjithë informacioni publikohet në UAlbania. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve nga trojet shqipfolese. Bazuar ne dokumentacion nuk ka patur aplikim nga student te huaj ne programin Teknikë Laboratori Mjekësor, ne UAL per arsye se ky program ofrohet vetem ne gjuhen shqipe. Institucioni bashkëpunon me RASH dhe QSHA per procedurat e rregjistrimit dhe transferimit te studenteve sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse (Ev. Shtese 23, 24



parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Praktike per miratimin e kriterëve dhe kuotave të pranimit).
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Procedura per miratimin e kriterëve dhe kuotave të pranimit ne programet e UAL bazohet ne Ligjin nr 80/2015 per Arsimin e Larte, ne Statutin e UAL neni 67, 71, 74, 75 dhe Rregulloren e UAL (Ev. 1; Ev. 3.1). Institucioni zbaton të gjitha kërkesat ligjore në lidhje me plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për të përfunduar procesin e regjistrimit, i cili dorezohet ne sekretarine mesimore perkatese (Ev. 6 Kontrate studenti). Regullorja e departamentit, rregullorja e programit te studimit dhe syllabuset paraqesin qarte dhe ne menyre te detajuar programin mesimor, format e mesimdhenies, menyren e kontrollit te dijeve, detyrat/projektet e kursit, procesin e diplomimit etj. (Ev. 17 Rregullore e programit; Ev 27.1.2.3 Syllabuset). Gjithashtu ne rregulloren e departamentit paraqiten qarte rregullat per nderprerjen e studimeve, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme (Ev. 6.2 Procedura e transferimit të krediteve). Komisioni i njohjes dhe transferimit te krediteve perгатit nje vendim, kopje e te cilit i jepet kandidatit dhe bashkelidhet gjithashtu ne dokumentat e tij te depozituara ne institucion. Informacionet e mesiperme janë te publikuara dhe lehtësisht të aksesueshme në faqen zyrtare të UAL. Ne takimin me studentet gjate vizites institucionale, GVJ konstatoi se studentet jane te kenaqur ne lidhje me informimin dhe komunikimin me sekretarite mesimore, zyren e keshillimit te karrieres dhe aksesimit te informacionit ne faqen web te institucionit dhe UAlbania (Vizita ne institucion).
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Përpara fillimit të çdo viti akademik, UAL organizon fushate informimi per programet e studimit, kriteret e përgjithshme e të veçanta të tij dhe disponon nje kalendar te ketyre aktiviteve (Ev. Shtese 11 Aktivitete për Studentët). Informacioni percillet dhe pasqyrohet përmes faqes zyrtare të UAL, e cila perditesohet vazhdimisht duke iu ofruar studentëve dhe të interesuarve një informacion të detajuar jo vetem per programet dhe kurrikulen por edhe në lidhje me aktivitetet studentore, akademiko-shkencore, sociale, kulturore etj. (Ev. Shtese 18 Nderfaqe te platformes UAL- LMS).

	Gjithashtu, UAL vë në dispozicion të studentëve dhe kandidatëve të interesuar materiale informuese si katalogu i universitetit (Ev. Shtese 12 Aldent Katalog), i cili reflekton zhvillimin e institucionit dhe programeve të tij, rrjetet sociale facebook dhe Instagram, adresa postare, email zyrtarë si dhe numra telefoni. UAL merr pjesë në panairin Work and Study e organizuara nga dhoma e tregtisë në qytetet e Shqipërisë që i japin mundësi këtij institucioni të promovojë programet që ofron dhe eventet e ndryshme që organizon në shërbim të studenteve (Vizita në institucion, takimi me studentet dhe stafin).
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	UAL planifikon kuota të dedikuara për studentët që vijnë nga disa kategori të veçanta sociale, studentë me aftësi të kufizuara/veçanta; studentë romë ballkano egjiptian, studentët me statusin e jetimit, fëmijë të policëve të rënë në detyrë, etj., në përputhje me strategjitë kombëtare përkatëse (Ev. Shtese 24 Praktike për miratimin e kuotave të studenteve). UAL harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara duke ofruar njëkohësisht mbështetje të vazhdueshme vecanerisht mbështetje financiare në kuadër të politikave mbështetëse për arsimin gjithëpërfshirës (Ev. 6.1 Politikat e mbështetjes së studentëve; Ev. Shtese 23, Praktike për miratimin e kriterëve të pranimit). Institucioni ofron infrastrukture të pershtatshme në ndihmë të studenteve me aftësi të kufizuara si rampa ashensore etj. (Ev. 13. 13.1; Vizita në institucion).
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	UAL harton dhe publikon kriteret dhe kuotat për kategoritë e studentëve nga trojet apo shtatetas të huaja që zoterojnë gjuhën shqipe përpara çdo viti akademik bazuar në historikun e kërkesave gjatë viteve paraardhëse. Këto kriteret janë në përputhje me aktet nenligjore të MAS (Ev. Shtese 23, 24 Praktike për miratimin e kuotave të studenteve dhe kriterëve të pranimit).
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për	Cdo vit akademik, UAL harton dhe ndjek politika mbështetëse të bursave dhe ndihmes financiare për studentët me mesatare të lartë hyrëse në Universitet, për studentët me aftësi të kufizuara, studentët romë, ballkano-egjiptian, studentët me stauze të vecanta. Këto vendime merren nga Bordi i Administrimit të UAL. Studentët e interesuar për fitimin e mbështetjes financiare duhet të paraqesin kërkesën në departamentin përkatës dhe dokumentacionin e nevojshëm në



zhvillimin ekonomik të vendit.	zyrat e protokollit të cilat me shkresë shoqëruese të Dekanit të Fakultetit shoqërohen për depozitim dhe shqyrtim në Bordin e Administrimit. Kjo procedure bazohet në Rregulloren e UAL, neni 36 (Ev. 3.1). Gjate shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ evidentoi se në politikat mbështetëse dhe financiare të institucionit përfshihen transporti falas, aktivitetet sportive të studenteve, mbremjet e fundvitit dhe diplomimit etj. të cilat financohen nga universiteti (Ev. 6.1; Ev. 6.2).			
Konkluzione	<i>UAL / FSHMT ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</i> <i>Çdo vit akademik, UAL mbështet studentet me bursa dhe ndihme financiare për studentët ekselentë dhe për shtresa në nevojë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	FSHMT, nepermjet rregullores së programit të studimit dhe syllabuseve, disponon për studentët e programit të studimit informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin (Ev. 27.1; Ev. 27.2; Ev. 27.3). Gjithashtu, për të ndjekur ecurinë dhe rezultatet akademike të studenteve, institucioni siguron informacion zyrtar edhe nepermjet sistemit të menaxhimit, i cili aksesohet nga stafi akademik me kohe të plote (Ev. 7). Ne rregullore, studenti gjen informacion për shkallën e frekuentimit të detyruar të programit të studimit: Frekuentimi i leksioneve, seminareve/ushtrimeve është i detyrueshëm në masën jo më pak se 75%. Frekuentimi i punëve

	laboratorike/detyrave te kursit/mesimit praktik eshte i detyrueshem ne masen 100% (Ev. 17, neni 8). Gjatë bisedës me studentet ne viziten institucionale, GVJ u informua se studentët njihen me kriteret e vlerësimit për secilën lëndë edhe në orën e parë të leksionit ku pedagogu përkatës bën prezantimin e syllabusit. Gjate vizites ne sekretari, GVJ verifikoi rregjistrat e frekuentimit te procesit mesimor nga studentet e cdo grupi mesimor, i cili plotesohet ne cdo ore mesimore nga pedagogu perkates. Ne rregullore studenti gjen informacion ne lidhje me kriteret e kalimit nga nje vit ne tjetrin (Ev. 3.2): 1. Studenti i vitit te pare kalon ne vitin e dyte nese ai ka marre jo me pak se 30 kredite te vitit te pare, e vlefshme per ciklin e pare dhe te dyte te programit te studimit; 2. Per programin e studimit te ciklit te pare, studenti i vitit te dyte kalon ne vitin e trete nese ai ka marre jo me pak se 90 kredite;
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Zyra e Sekretarisë Mësimore te FSHMT informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Rregullorja e departamentit dhe e programit te studimit ka nene specifike per procedurat e transferimit, ekuivalentimit te lendeve si dhe per mundesine e ndjekjes se programeve te dyta. Universiteti Aldent lejon transferimet e studenteve ne hyrje dhe ne dalje Brenda programeve te te njejtit cikel studimi nga IAL vendase dhe te huaja. Në nivel dekanati ngrihet Komisioni i Ekuivalentimit te programeve, i cili vlereson dhe njeh kualifikimet e meparshme, shqyrton kerkesen e studentëve për transferimin e krediteve. Kreditet e transferuara të studentëve hyjnë në fuqi me miratimin e Rektoratit. Nje lende/modul ekuivalentohet kur ajo ka nje perputhje te permbajtjes se saj dhe te ngarkeses ne auditor jo me pak se 80% (Ev. 6.2).
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit jane te specifikuar ne rregulloren e programit te studimit (Ev. 17). Vleresimi i studenteve mbeshetet ne vleresimin semestral/vjetor te punes ne auditor, rezultateve te praktikave, laboreve, seminareve, detyrave, projekteve etj, por provimi eshte forma kryesore per kontrollin e dijeve te pervesuara. Studenti gjen informacion te detajuar edhe ne syllabuset e lendeve, i cili, gjithashtu, per cdo paqartesi kerkon ndihme ne



	sekretarine mesimore ose tek pedagogu perkates. Syllabusi i çdo lënde të programit të studimit përcakton mënyrën dhe kriteret e vlerësimit të studentëve (Ev. 27 Syllabuset). Kontrolli i dijeve behet me shkrim/me goje/i kombinuar. Menyrat e vlerësimit dhe detyrimet i behen te ditur studenteve ne fillim te procesit mesimor, kurse piket e fituara dhe vleresimet gjate vitit i behen te njohura para provimit (Ev. 17). Ne takimin me studentet, GVJ konstatoi se studentet ishin te kenaqur me transparencen e vlerësimit dhe kishin te drejten per rishikimin e tezes se provimit (Vizita ne institucion).
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Rregullorja e FSHMT dhe e programit te studimit Bsc Teknik Laboratori Mjekjekësor, percakton qarte kriteret dhe procedurat e diplomimit. Sipas rregullores, studentet e programeve te ciklit te pare te studimeve diplomohen me provim te pergjithshem perfundimtar. Bazuar në këto rregullore, Pergjegjesi i programit informon studentët lidhur me kriteret e diplomimit, programet dhe temat perkatese te provimit te formimit, proceduren e vlerësimit, mundesine e ankimimit dhe rivlerësimit me qëllim që t'u krijojë atyre kushtet e nevojshme për realizimin me sukses të ketij procesi (Ev. 17; Ev. 3.2) Bazuar ne dokumentacionin ne dispozicion (diploma dhe suplementi i diplomes), GVJ konstatoi se emertimi i diplomes perputhet me programin e studimit, objektivat formuese dhe karakterizuese te tij (Ev. 25).
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike stafi akademik dhe administrativ i FSHMT organizon ditë të hapura (open day) për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit dhe infrastrukturën e institucionit. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI realizon gjurmimin e studentëve dhe luan rol në informimin e tyre për çdo paqartësi edhe gjatë frekuentimit të vitit akademik (Vizita ne institucion). Institucioni ka publikuar katalogun e shkolles, flete informuese si edhe perditese ne faqen zyrtare web, rrjetet sociale te UAL me qellim promovues dhe informues te programeve te studimit (Ev. shtese 12, Aldent Katalog).
Konkluzione	<i>Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në</i>

	tjetrin, procedurat e vlerësimit të dijeve dhe diplomimit në programin e studimit. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, UAL / FSHMT informon publikun dhe studentet e ardhshëm mbi programin e studimit duke organizuar dite të hapura dhe duke publikuar katalog dhe flete informuese si edhe informacione të perditesuara ne faqen zyrtare web te universitetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Studentët që ndjekin programin bachelor Teknikë Laboratori Mjekësor, informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit nga përgjegjësi i programit, tutori akademik, platforma UAL/LMS (Ev. shtese 18, Nderfaqe te platformes UAL- LMS), takimet me stafin akademik, faqja zyrtare ne rruge elektronike apo katalogu i shkolles i publikuar (Ev. shtese 12, Aldent Katalog). Kandidatët e interesuar mund të aksesojnë në formatin hardcopy dosjen e programit të studimit pranë zyrave të shërbimit të studentëve. Ata gjejnë informacion mbi objektivat formuese të programit, planet mesimore, syllabuset, rregulloren, suplementin e diplomes etj. (Vizita ne institucion).
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Institucioni disponon dokumentacion për programin e studimit/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese i organizuar ne perputhje me aktet nenligjore ne fuqi (Ev. shtese 12). Studenti gjen informacion për organizimin dhe shpërndarjen e lendeve ne semestral, kreditet per secilen prej tyre, klasifikimin e lendeve sipas llojit te veprimtarise formuese (Ev. 24). Studenti merr informacion gjithashtu nga syllabuset (Ev. 27) si edhe nga faqja zyrtare web e institucionit. GVJ evidentoi se cdo informacion ne lidhje me modulet publikohet ne klasen e formuar per studentet ne



	platformen UAL e Learning (Ev. shtese 18). Gjate vizites institucionale u evidentuan gjithashtu tabela informuese per planin mesimor ne auditoret e leksioneve (Vizita ne institucion).
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Gjate vizites institucionale, ne takimin me perfaqesues te Zyres se Keshillimit te Karrieres, GVJ kerkoi informacion per mundesite e punesimit te studenteve (Vizita ne institucion). Per me teper, gjate shqyrtimit te dokumentacionit te vene ne dispozicion (Ev. 3.2), GVJ konstatoi se Zyra e Karrieres organizon gjate vitit një numër te konsiderueshëm aktivitetesh me natyrë orientuese e këshilluese të studentëve drejt tregut të punës si psh aktivitet informues për progamin “Work and Travel”, takim Informues për punësimin e studentëve në Gjermani gjatë muajve të verës nga Victoria Recruitment, “Fuqizo punësimin tënd” si pjesë e projektit të Këshillit të Europës i quajtur “ENTER” (Ev. Shtese 11 Aktivitete për Studentët).
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Gjate shqyrtimit te dokumentacionit, GVJ evidentoi se studentët marrin pjesë edhe në ditët e hapura te organizuara nga institucioni në fillim të çdo viti akademik, ku gjatë vizitave të tyre në ambientet e universitetit informohen në lidhje me zyrat dhe shërbimet e ndryshme që ato ofrojnë (Ev. 13, Ev. shtese 12). Gjithashtu, GVJ ne takimin me studentet konstatoi se studentet ishin te mireinformuar per infrastrukturen, organizimin e programit si syllabuset, oraret mesimore, organizimin e praktikave profesionale dhe oreve te laboratorit. Ne sherbim te studenteve jane biblioteka, Zyra e Keshillimit dhe sekretaria mesimore. Gjithashtu gjate pandemise COVID 19 procesi mesimor u realizua nepermjet Platformes eLearning.
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Universiteti Aldent disponon sistemin e menaxhimit Fx Education permes te cilit studenteve iu ofrohet informacion ne lidhje me programin e studimit. Zyra e IT-s u jep mundesine studenteve te logohen me te dhenat e tyre personale për të pasur akses në listën e tyre të notave, mungesat si dhe situatën e tyre financiare (Ev. 7). Informacioni dhe akses i platformën Fx Education është lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance nepermjet rubrikes "portal i studentit" ne faqen zyrtare te universitetit (http://portalonline.ual.edu.al).
Konkluzione	<i>Universiteti Aldent siguron per programin e studimit Bsc ne Teknikë Laboratori Mjekësor, infrastrukturen e nevojshme dhe</i>

	<i>informacion te perditeluar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, organizimin e syllabuseve, literaturen e nevojshme, orarin e mesimit, praktikave profesionale dhe oret laboratorike, aktivitetet jashte kurrikulare.</i> <i>Studentët qe ndjekin programin e studimit informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit nga pergjegjesi i programit, tutori akademik, platforma UAL e Learning, takimet me stafin akademik, faqja zyrtare ne rruge elektronike apo katalogu i shkolles i publikuar.</i> <i>Institucioni mundeson perfshirjen e studenteve ne aktivitete informuese dhe mbeshtetese per orientimin dhe promovimin e tyre drejt tregut te punes.</i> <i>Institucioni disponon system te menaxhimit te brendshem te informacionit lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	FSHMT ne Universitetin Aldent disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve sipas programit te studimit, të diplomuarit dhe të dhënat e licensimit të tyre (Ev. 3.4; Ev. 23, tab. 15 Studentet). Gjate vizites institucionale ne sekretarine mesimore, GVJ konstatoi se sekretaria disponon rregjistrin themeltar te studenteve, rregjistrin e leshimit te diplomave, rregjistrin me te dhenat akademike, te cilat depozitohen ne institucion dhe disponohen edhe ne forme elektronike. Gjate shqyrtimit te dokumentacionit, GVJ evidentoi se institucioni disponon informacion te perditeluar cdo vit mbi kalueshmerine ne provimin e shtetit dhe licensimin e studentëve qe jane diplomuar ne Universitetin Aldent per programin Bsc Teknikë Laboratori Mjekësor (Ev. shtese 36 Te dhena nga QSHA per licensimin e studenteve).

Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Institucioni disponon sistem menaxhimi qe mundeson dhe ruan të dhënat e studentëve të regjistruar në programin e studimit, studentet që diplomohen, studentë që ndërpresin përkohësisht ose në mënyrë të përhershme studimet. Ky system menaxhohet nga sekretaria mesimore e cila i perdor keto te dhena per raportime te ndryshme apo analiza statistikore në zbatim të udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ASCAL-it apo QSHA-së, etj. (Ev. 3.4) Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimeve ne institucion, GVJ konstatoi gjithashtu se sekretaria disponon dosjet e studenteve te plotesuar sipas kuadrit ligjor, listat e studenteve frekuentues, dokumente te transferimit, rregjistrimit ne programe te dyta dhe te ç'rregjistrimit te tyre. Nga vizita pranë Sekretarisë Mësimore u konstatua administrimi në mënyrë të rregullt i të dhënave të studentëve për të gjithë ciklin akademik. Nga të dhënat e mara evidentohet si vijon: <table><tr><th>Viti akademik</th><th>Nr i të regjistruarve</th><th>Nr i të cregjistruarve</th><th>Nr aktual</th></tr><tr><td>2021-2022</td><td>66</td><td>4</td><td>62</td></tr><tr><td>2022-2023</td><td>61</td><td>2</td><td>59</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>67</td><td>0</td><td>67</td></tr><tr><td>Totali</td><td colspan="3">188</td></tr></table>	Viti akademik	Nr i të regjistruarve	Nr i të cregjistruarve	Nr aktual	2021-2022	66	4	62	2022-2023	61	2	59	2023-2024	67	0	67	Totali	188		
Viti akademik	Nr i të regjistruarve	Nr i të cregjistruarve	Nr aktual																		
2021-2022	66	4	62																		
2022-2023	61	2	59																		
2023-2024	67	0	67																		
Totali	188																				
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit Fx Education. Aksesit në arkivin elektronik është i dedikuar dhe administrohet nga personeli informatik që ka rektorati dhe fakultetet. Kjo platforme perdoret lehtësisht edhe nga sekretaria mësimore, si njësi e autorizuar për hedhjen, verifikimin dhe ruajtjen e të dhënave (Ev. 7). <i>Në kuadër të ruajtjes së të dhënave personale, informacioni personal i studenteve ruhet ne menyre konfidenciale dhe shperndahet vetem per palet e autorizuara ne perputhje me aktet nenligjore ne fuqi dhe rregulloren e UAL. (Ev. 3.1).</i> Ne viziten institucionale ne sekretarine mesimore te FSHMT, GVJ inspektoi dokumentacionin e arkivuar dhe u informua se sekretaria disponon dokumentacion ne dy formate, fizik (kopja në letër) dhe elektronik. Të dhënat e studentëve ruhen në versionin zyrtar dhe skanohen në formatin elektronik.																				



Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritet mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Bazuar ne Statutin dhe Rregulloren e UAL (Ev. 1; Ev. 3.1), me vendim senati institucioni ka ngritur Grupin e Auditit të Brendshëm, i cili ka kryer kontrole periodike pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritet mësimore, departamentet, sistemin e menaxhimit të brendshëm), i cili ka bere vleresimin e informacionit dhe dokumentacionit që lidhet me studentët, veprimtarinë e tyre përkatëse, duke siguruar zbatimin e duhur dhe respektimin e kërkesave ligjore të dala nga organet kolegjiale apo drejtuese të institucionit. GVJ evidentoi disa nga rezultatet e auditimit te brendshem ne raportet e tyre vjetore dhe shqyrtimit te dokumenteve te tjera te vene ne dispozicion (Ev. shtese 21; Ev. shtese 30 Raport per auditimin e brendshem). Gjithashtu, administratori i institucionit monitoron ne menyre te vazhdueshme punen e sekretarise mesimore (Ev. 3.4; Ev. 3.7; vizita e GVJ ne sekretari).
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Bazuar ne dokumentacion, GVJ gjeti raporte analitike te hartuara nga institucioni, njësia bazë FSHMT, koordinatori i programit dhe NJSBC ne formen e analizes vjetore. Keto raporte ofrojne informacion mbi veprimtarine mesimore, kerkimore/shkencore, financiare, monitorimin e provimeve dhe diplomimit, profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve. Gjate takimit me perfaqesues te Zyres se Karrierës dhe Alumnit, GVJ u informua se studentet te diplomuar ne programin Teknikë Laboratori Mjekësor dhe te licensuar nga provimi i shtetit janë punësuar në laboratore private dhe publike. Gjate takimit u deklarua gjithashtu se te dhenat per punesimin merren nga Urdhri i Infermierit te Shqiperise dhe se ka nje interes te shtuar te studenteve per punesim jashte vendit. Pavaresisht deklarimit, GVJ gjate shqyrtimit te dokumentacionit nuk gjeti evidence me statistika per Alumni nga Urdhrat profesionale ne lidhje me punesimin. <u>Rekomandim:</u> Të rritet më shumë bashkëpunimi me urdhrat profesionale për të vlerësuar shkallën dhe cilësinë e punësimit të studenteve, informacion i cili duhet te pasqyrohet qarte ne raportin analitik institucional duke u shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.
Konkluzione	Institucioni disponon statistika vjetore per numrin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

Alto Retaj

	<i>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit Fx Education dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</i> <i>Njesia baze dhe strukturat në shërbim të studentëve hartojnë raporte analitike vjetore mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve por, GVJ gjatë shqyrtimit të dokumentacionit nuk gjeti evidence me statistika për Alumni nga Urdhrrat profesionale në lidhje me punësimin.</i> <i>GVJ rekomandon rritjen e bashkëpunimit me urdhrat profesionale për të vlerësuar shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve, informacioni i cili duhet të pasqyrohet qartë në raportin analitik institucional duke u shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë (LAL 80/2015, neni 54, 55), Statutin e UAL dhe rregulloren e FSHMT të Universitetit Aldent, institucioni garanton përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ evidentoi se 10% e studentëve janë përfaqësues në Senatin Akademik të UAL, 1 përfaqësues i Keshillit Studentor në përberjen e NJSBC në nivel rektorati (Ev. 1; Ev. 3.2). Gjithashtu studentet janë organizuar në Keshilla Studentore në nivel universiteti dhe fakulteti. Keshillat studentore e bazojnë aktivitetin e tyre në Statutin dhe rregulloren e Keshillit Studentor. Studentet përfaqësohen gjithashtu edhe në Senatin Studentor (SS) i cili është organi kolegjal vendimarrës i Keshillit Studentor. Anëtarët e SS zgjidhen çdo 2 vjet nga komuniteti studentor i Fakulteteve të UAL (Ev. 3.5).

Alisa Reta

	Studentet kane qene pjesemarres edhe ne hartimin e RVB, gje qe u konstatua jo vetem nga perberja e komisionit ne dokumentacion por edhe ne takimin me perfaqesues te GVB ne viziten institucionale.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vendimmarrje nepermjet përfaqësuesve të tyre ne zgjedhjet per organet dhe autoritet drejtuese si Senati Akademik, NJSBC, Keshilli Studentor, Senati Studentor etj. (Ev. 3.1) Gjate takimit me studentet, GVJ konstatoi se studentet plotesojne cdo vit akademik pyetesoret duke dhene vleresimin e tyre mbi procesin akademik (Ev. 11). Ata konfirmuan gjithashtu se marrin pjese aktive ne aktivitete promocionale (Ev. 23 tabela 18) dhe projekte studimore ne bashkepunim me pedagoget e tyre, gje qe eshte lehtësisht e verifikueshme ne dokumentacionin e vene ne dispozicion te GVJ (Ev. shtese 34 Raporti vjetor institucional; Vizita institucionale, takimi me studentet).
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	FSHMT si njësi përgjegjëse e programit te studimit, perdor nje seri mekanizmesh për përfshirjen e studentëve ne përmirësimin e programit të studimit. Institucioni ka mundesuar pjesemarrjen e studenteve ne organe kolegjiake dhe komisione te rendesushme si NJSBC, komisioni i kurrikulave, komisioni i kerkimit shkencor, GVB etj. (Ev. 1; Ev. 3.2; Ev shtese 37; Ev. 28). Gjithashtu, Senati Studentor eshte organi ku studentet diskutojne problematikat ne procesin e mesimdhënies dhe kane te drejten e rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit bazuar edhe ne rregulloren me te cilen funksionon Senati (Ev. 3.5). Studentet shprehin opinionin e tyre ne lidhje me kurrikulen dhe programin mesimor edhe nepermjet pyetesoreve te plotesuar prej tyre (Ev. 11). Gjate takimit me studentet, ata vleresuan se programi permbush pritshmerite e tyre dhe i pergatit per tregun e punes (Takimi i GVJ me studentet, vizita ne institucion). Institucioni ne bashkepunim me keshillat studentore kontribon ne përmirësimin e jetës profesionale dhe sociale të studentëve nepermjet mbështetjes me kapacitete akademike dhe bursa financimi (Ev. 6.1).
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë	Ne rregulloren e FSHMT dhe te programit te studimit percaktohet qarte procedura e ankimimit te studentit per rezultatin e provimit (Ev. 3.2; Ev. 17). Kur studenti ka ankimim per vleresimin i drejton kerkese me shkrim Komisionit te Provimit brenda 48 oreve, i cili eshte i detyruar te sqaroje studentin ne lidhje me vleresimin. Nese studenti nuk bie dakord me vleresimin e komisionit te provimit depoziton

mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	ankese zyrtare tek drejtuesi i departamentit, i cili ben verifikimet e duhura se bashku me komisionin e provimit dhe njofton studentin per vendimin e marre. Kur studenti nuk eshte dakord edhe me vendimin e njesise baze, depoziton ankese me shkrim ne sekretarine e dekanit brenda 48 oreve nga marrja e njoftimit. Ankesa shqyrtohet nga dekani dhe në rastin kur kërkesa miratohet, Dekani ngre një komision ad-hoc për rishikimin e tezës (Ev. 3.6; Ev. 17). Kjo u konfirmua edhe ne takimin me studentet, te cilet ishin te kenaqur me proceduren dhe transparencen e zhvillimit te provimeve (Takimi me studentet, vizita ne institucion).			
Konkluzione	<i>Bazuar ne Ligjin per Arsimin e Larte, Statutin e UALdhe Rregulloren e FSHMT, institucioni garanton përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese.</i> <i>Perfshirja e studenteve ne vendimmarrje dhe vleresim te procesit akademik realizohet permes përfaqësuesve të tyre ne zgjedhjet per organet dhe autoritet drejtuese si Senati Akademik, NJSBC, Keshilli Studentor, Senati Studentor etj si edhe permes vleresimit te opinionit te tyre nepermjet pyetesoreve ne lidhje me kurrikulen, cilesine e mesimdhenies, raportit teori/praktike dhe pjesemarrjes ne aktivite shkencore dhe promocionale. Studentet kane qene pjesemarres edhe ne hartimin e RVB.</i> <i>Ne rregulloren e FSHMT, rregulloren e provimit dhe te programit percaktohet qarte procedura e ankimimit te studentit per rezultatin e provimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të	Institucioni disponon procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. Në shërbim të informimit të studentëve jane Sekretaria Mësimore,

studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Karrierës dhe Alumni, Sherbimi i Tutoriatit, Zyra e IT. Vecanerisht Zyra e Informimit dhe Keshillimit të Karrierës informon studentet jo vetëm për programet e studimit dhe perspektiven profesionale të tyre por edhe për mundësitë e punësimit në të ardhmen e tyre (Ev. 3.3; 3.4; 3.8; 3.9).
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Sistemi për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve është funksional dhe bazohet në misionin dhe detyrimet e strukturave përgjegjëse të përmendura në kriterin 1. Kjo struktura mbështet dhe informon studentet në lidhje me aktivitetin akademik, karrierën që do të ndjekin, licensimin dhe akreditimin e programeve etj. (Ev. 3.9). Në takimin me studentet, ata u shprehën të kenaqur lidhur me disponibilitetin e këtyre strukturave për informim dhe shërbime. Bazuar në dokumentacionin por edhe në takimin me përfaqësues të Zyres së Keshillimit të Karrierës në viziten institucionale, GVJ u informua se institucioni ka organizuar gjithashtu aktivitete në mbështetje të studentëve me qëllim informues si aktivitet informues për programin "Work and Travel", aktivitetin "Fuqizo punësimin tënd", "Ditët e informimit të maturantëve" etj. (Ev. shtesë 11 Aktivitete për Studentët).
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Në institucion funksionon Zyra për Këshillimin e Karrierës dhe Alumni e cila informon dhe mbështet studentet për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Ky sektor gjithashtu organizon dhe koordinon aktivitete shkencore si trajnime, seminare, workshop, konferenca të alumneve, orë leksioni të hapura nga lektorët e ftuar, promovon aftësitë dhe prirjet e studentëve në fusha të tjera si lehtësi, art etj., aktivitetet kulturore dhe sportive (Ev. shtesë 11 Aktivitete për Studentët). Ajo harton guidën dhe fletëpalosjet informuese vecanerisht për studentet e vitit të parë, materialet udhëzuese për maturantët të dhëna statistikore mbi numrin e studentëve aktualë, studentëve të diplomuar, zhvillimin e strategjive për punësim etj. (Ev. 3.8).
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna	Në takimin me përfaqësues të Zyres së Karrierës por edhe në shqyrtimin e dokumentacionit, GVJ verifikoi se kjo njësi disponon të dhëna për të diplomuarit mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit, ndjek integritetin e tyre në tregun e punës dhe

mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	mban kontakte me studentët e diplomuar nepermjet adresave te tyre personale te email me qëllim bashkëpunimin për interesa të përbashkëta (Ev. 3.8). Ruajtja e kontakteve realizohet gjithashtu edhe nepermjet faqes ne rrjetet sociale "Alumni Aldent". Zyra e Keshillimit te Karrieres dhe Alumni mban te dhena statistikore lidhur me numrin e studenteve te punesuar dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse (Ev. 23 Tabelat).			
Konkluzione	<i>Universiteti Aldent disponon procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. Ne funksion te informimit jane Sekretaria Mësimore, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Karrierës dhe Alumni, Sherbimi i Tutoriatit, Zyra e IT.</i> <i>Zyra e Karrierës dhe Alumnit realizon informimin e studenteve dhe sherbime te tjera nga momenti rregjistrimit deri ne diplomimin e tyre. Ajo mban kontakte me studentët e diplomuar nepermjet adresave te tyre personale te email dhe disponon database për të diplomuarit mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit te cilat perditesohen vazhdimisht duke hartuar njekohesisht edhe raporte statistikore. Informacioni i Alumnit i vihet ne dispozicion departamentit perkates me qëllim bashkëpunimin për interesa të përbashkëta.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel	Gjate shqyrtimit te dokumentacionit, GVJ evidentoi se UAL ka hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe

Handwritten signature: H. R. R. R.

institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. UAL ka në focus përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe integrimin e përdorimin e metodave innovative të mësimdhënies bazuar në karakteristikat e programit dhe specifikat e lëndëve. Strategjia e mësimdhënies mësimnxënies dhe metodave të vlerësimit e hartuar për periudhën 2021-2025 ka si qëllim arritjen e objektivit për formimin e studjuesve të rinj në fushën mjeksore nepermjet programeve universitare mesimore/shkencore të një niveli të përparuar dhe bashkohor teorik, metodik dhe praktik (Ev. 2). Për arritjen e këtij misioni dhe në kuadër të strategjise për nderkombetarizimin është bërë e mundur mobiliteti i stafit në universitete prestigjioze për të përfituar përvoja akademike ndërkombëtare dhe për të implementuar metoda inovatore të mësimdhënies dhe të të nxënit me në qendër studentin (Ev. 10). Në strategjinë e Universitetit Aldent theksohet se institucioni siguron gjithashtu një infrastrukturë moderne dhe bashkekohore didaktike dhe laboratorike për një mesimdhënie gjithëpërfshirëse (Ev. 3.8). Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik të angazhuar në programin e studimit u evidentua përdorimi i metodave interaktive dhe innovative të mësimdhënies si studimi i rasteve. Njësia bazë ka hartuar rregulloren “Përshkrimi i laboratorëve në funksion të programit” (Ev.20), ku pasqyrohet se si shfrytëzohen dhe sat ë sigurtë janë këto ambiente në funksion të programit të studimit.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Universiteti Aldent ka miratuar dhe ka funksional strukturën e sigurimit të cilësisë, e cila është përgjegjëse për vlerësimin dhe monitorimin në mënyrë periodike të programeve të studimit dhe performancës në mesimdhënie dhe inovacion të personelit akademik dhe ndihmësakademik (Ev. 3.3; Ev.8). Në zbatim të ligjit dhe akteve nenligjore NJSBC zhvillon në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve pyetësoret e studenteve për matjen e performancës dhe cilësisë në mesimdhënie. Rezultatet e pyetësoreve u bëjnë ditur autoriteteve drejtuese në rektorat, dekanat, departament si edhe pedagogëve përkatës duke analizuar nevojat dhe sugjerimet e studenteve (Ev.11). Gjithashtu Universiteti Aldent përdor një sërë mekanizmash të tjera monitorues për identifikimin e cilësisë në mesimdhënie si ndjekja e procesit mesimor prej drejtuesit të departamentit, koordinatorit të programit, kontakti i përditshëm i tutorit me studentet, vlerësimi i performancës akademike nepermjet formulareve përkatës (Ev. 4.1), përditesimi i vazhdueshëm i CV të stafit që është tregues për

	rritjen e kualifikimeve ne funksion te cilesise akademike dhe aftesise ne mesimdhënie (Ev. 28).
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Statuti i UAL sanksionon te drejten e studenteve per te qene pjese e strukturave përgjegjëse per sigurimin dhe standartet e cilesise, por edhe te komisioneve te tjera ne nivel institucional, njesie baze dhe departamenti. Studentet përfshihen në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve (Ev.1). Gjithashtu, institucioni gjurmon pakënaqësitë ose kërkesat e ndryshme të studentëve nepermjet zhvillimit online/on site te ankimimeve te tyre me natyrë akademike dhe administrative. Per vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, NJSBC aplikon pyetesorin per studentet (Ev.11). Ne kete menyre, studentet japin kontributin e tyre ne zhvillimin institucional dhe sigurimin e cilesise.
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Institucioni dhe njesite baze te tij hartojne raporte dhe analiza vjetore per vlerësimin e veprimtarise dhe performances akademike ne zbatim te politikave per sigurimin e brendshem te cilesise e sanksionuar ne nenin 103 te Ligjit per Arsimin e Larte nr 80/2015: "Sigurimi i Brendshem i Cilesise" (Ev. shtese 31, 34). Drejtuesi i departamentit ben vlerësimin e performancës së stafit akademik nepermjet plotesimit ten je formulari qe perfshin mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe sherbimin administrativ apo mbështetës (Ev. 4.1). Cdo fund viti akademik, NJSBC publikon raportin vjetor ne lidhje me sigurimin e brendshem te cilesise ne te cilin perfshin nje plan masash per permiresimin e treguesve te ulet (Ev.8). Njekohesisht, ne kuader te transparences, NJSBC publikon raportet përfundimtare të akreditimit të programeve të studimit në faqen zyrtare të UAL. Gjithashtu, sic u theksua edhe me lart, NJSBC ben publike rezultatet e pyetesoreve te studenteve duke adresuar sugjerimet e tyre ne mbështetje te rritjes se cilesise dhe standarteve te mesimdhënies (Ev.11). Tregues per monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ te institucionit eshte edhe raporti i grupit te auditimit, i cili ngrihet ne rast nevojë per problematika te ndryshme qe mund te shfaqen ne aktivitetin institucional (Ev. shtese 30 Raport per auditimin e brendshem).
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve	Institucioni përdor instrumente dhe mekanizma të brendshëm për vlerësimin e stafit akademik, të cilat kanë për qëllim nxitjen

të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	e personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies dhe promovimin e praktikave më të mira. Gjate shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ evidentoi disa instrumente për vlerësimin e stafit akademik siç janë <i>pyetësorët</i> e plotësuar nga studentet apo analizat statistikore nga NjSBC dhe fakultetet bazuar në rezultatet e tyre, <i>raporti vjetor</i> në nivel fakulteti dhe institucional që vlerëson veprimtarinë mësimore, aktivitetin botues dhe kërkimor-shkencor të stafit akademik si edhe <i>raport vlerësimi i performancës individuale</i> me komentet dhe sugjerimet që i përcillen Rektoratit nga përgjegjësit e departamenteve të çdo njësie bazë (Ev.4.1, 11, 31, 34). Në keto raporte janë promovuar shembuj të praktikave të mira dhe janë evidentuar adresim i problematikave dhe objektivat për përmirësimin e tyre			
Konkluzione	<i>Universiteti Aldent ka hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies sic është strategjia e institucionit për vitin 2021–2025.</i> <i>Institucioni ka miratuar dhe ka funksional struktura të sigurimit të cilësive, të cilat janë përgjegjëse për vlerësimin dhe monitorimin në mënyrë periodike të programeve të studimit. Kjo njësi, bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe aktet nënligjore zhvillon dy herë në vit pyetësorët e studenteve për matjen e performancës dhe cilësive në mësimdhënie. Sistemi i sigurimit të brendshëm funksionon në nivel institucional.</i> <i>Universiteti Aldent përdor një sërë mekanizmesh të tjera monitorues për identifikimin e cilësive në mësimdhënie si ndjekja e procesit mësimor prej drejtuesit të departamentit, koordinаторit të programit, kontakti i përditshëm i tutorit me studentet, vlerësimi i performancës akademike nëpërmjet formulareve përkatës</i> <i>Institucioni përdor instrumente dhe mekanizma të brendshëm për vlerësimin e stafit akademik. GVJ gjeti raporte që promovojnë shembuj të praktikave të mira, adresim të problematikave dhe objektivat për përmirësimin e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë, standardeve të hapësirës evropiane të sigurimit të cilësisë, Universiteti Aldent ka ndertuar politika dhe procedura si edhe ka ngritur struktura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, të cilat janë të sanksionuara në Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme të UAL. Në mbështetje të këtij kuadri ligjor, UAL ka ngritur dhe është në funksionim Njesinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), e cila ka përfaqësues nga të gjitha njesitë kryesore të Universitetit Aldent. Referuar rregullores së NJSBC, kjo njesi është përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së aktivitetit mesimor/shkencor, infrastrukture, burimeve njerëzore dhe rezultateve të studenteve (Ev. 3.3). Gjate shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ gjeti evidence të formatit të pyetësoreve të studenteve për vlerësimin e cilësisë së mesimdhënies dhe shërbimeve administrative, formatin për vlerësimin e performancës së stafit akademik dhe administrativ (Ev. 4.1; Ev.11), vendimin për ngritjen e komisioneve në nivel institucional për veprimtari të ndryshme në shërbim të institucionit si Këshilli i Etikës, Komisioni i Përhershëm i Projekteve dhe Kerkimit Shkencor, Komisioni i Përhershëm i Kurrikulave dhe Standarteve, Njesia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë etj. (Ev. shetese 37).
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorët e ekspertëve të jashtëm.	UAL ka ngritur Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ku funksionon edhe NJSBC. Njesia e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë është ngritur me urdher të Rektorit dhe është organ kolegjal, përberja e të cilit miratohet me vendim të senatit (Ev. shetese 37). Ajo e bazon aktivitetin e saj në legjislacionin në fuqi, në Standartet Shtetërore të Cilësisë, Statutin dhe Rregulloren e UAL, Standartet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë, vendimet e senatit, urdhrat e brendshëm dhe kodin e cilësisë miratuar me VKM (Ev. 3.3). Politikat për sigurimin e cilësisë janë përshkruar edhe në Planin e Zhvillimit Strategjik 2021-2025 të UAL (Ev. 2). NJSBC ka përmbushur detyrimin ligjor për të hartuar një raport vjetor për veprimtarinë e saj. Ajo funksionon si një strukturë e pavarur dhe e përhershme pranë institucionit dhe ushtron një sërë aktiviteteve në mbështetje të sigurimit të cilësisë në

	institucion (Ev. 8). Bazuar ne shqyrtimin e dokumentacionit te vene ne dispozicion, GVJ gjeti evidence te bashkepunimit me institucione te tjera te arsimit te larte per te ndare praktikat me te mira (Ev. 9.1; 9.2) por edhe me eksperte te jashtem per te vleresuar performancen e stafit akademik, administrativ dhe te insitucionit ne teresi. Shembuj te tille jane anketimi i studenteve dhe stafit nga Instituti per Cilesi ne Arsim, kontrolli i pervitshem i MAS ne auditimin e institucionit per plotesimin e standarteve te stafit akademik dhe infrastruktures etj (Ev. shetese 30, 32).
Kriteri 3. Institucioni perdor instrumentet dhe treguesit e duhur per sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	GVJ, bazuar ne dokumentacion dhe ne takimin me perfaqesues te NJSBC, evidentoi se institucioni perdor instrumentet dhe treguesit e duhur per sigurimin e cilësisë si sondazhet me studentët, vlerësimin e performancës së personelit akademik, takime/trajnime dhe me eksperte te fushes, vezhgime te procesit mesimor dhe monitorimit te provimeve etj. (Ev. 4.1; Ev. 11; Ev. shtese 16) Vetëvlerësimi apo vlerësimi i jashtëm institucional i UAL nga eksperte vendas dhe te huaj te aprovuar nga ASCAL, kanë qenë dhe janë gjithashtu procese të rëndësishme që ndikojnë në përmirësimin e cilësisë dhe mekanizmave të sigurimit të saj brenda institucionit (Ev. shtese 30 Raport per auditimin e brendshem; Ev. 32). Institucioni ka respektuar dhe permbushur rekomandimet nga grupet audituese (Vizita institucionale).
Kriteri 4. Institucioni perdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit.	UAL/FSHMT perdor tregues të qartë, të matshëm në vleresimin e mesimdhënies dhe kerkimit shkencor nepermjet plotesimit te formularit te performancës se stafit akademik dhe administrativ. Ky vleresim behet nga pergjegjesi i departamentit dhe perfshin vlerësimin për veprimtarinë akademike per cdo pedagog, vlerësimin e aktivitetit shkencor të stafit akademik nëpërmjet evidentimit të artikujve të botuar dhe prezantimeve orale kombëtare dhe ndërkombëtare, vleresimin e aktivitetit administrativ te tyre si korrektesinë në kryerjen e tyre, realizimin e shërbimeve ndaj studentëve, respektimin e afateve kohore të këtyre aktiviteteve dhe të rregullores së fakultetit (Ev. 4.1). Drejtuesit e te gjitha strukturave mbikqyrin zbatimin e rregulloreve dhe programit mesimor dhe pergatisin raportet e tyre vjetore qe permbledhen edhe ne raportin institucional (Ev. 8; Ev. 22; Ev. shtese 31, 34). Institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit (Vizita institucionale, takimi me

	perfaqesues te NJSBC, Dekanin, Drejtuesit e Departamenteve).			
Konkluzione	<i>Në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë, standardeve të hapësirës evropiane të sigurimit të cilësisë, Universiteti Aldent ka ndertuar politika dhe procedura si edhe ka ngritur struktura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, të cilat janë të sanksionuara në Statutin dhe Rregulloren e UAL.</i> <i>Njesia e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë është ngritur me urdher të Rektorit dhe është organ kolegjal, perberja e të cilit miratohet me vendim senati. NJSBC funksionon si një strukturë e pavarur dhe e përhershme pranë institucionit duke ushtruar një sërë aktivitete bazuar në rregulloren e NJSBC.</i> <i>Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin e performancës së stafit akademik dhe administrativ.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.	Ne funksion te akreditimit te programit te studimit të ciklit të parë, institucioni monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike ecurinë e programit duke përdorur mekanizma e procese formale të dokumentuara. Gjate takimit me drejtues te institucionit dhe perfaqesues te NJSBC, GVJ konstatoi se Universiteti Aldent perdor disa mekanizma për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë: – Monitorime nga koordinatori i programit të studimit si person përgjegjës i cili bashkëpunon me departamentet për ecurinë e programit (Ev.22). – Monitorime të procesit mësimor nga përgjegjësit e departamenteve, të cilët në analizen vjetore evidentojnë arritjet, dobësitë dhe planin e masave për përmirësim (Ev. shtese 31).

Handwritten signature: A. J. R. R. R.

Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	– Monitorime nga NJSBC ne nivel institucional i cili harton edhe nje raport vjetor per evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim (Ev. 8). – Realizim sondazhesh dhe mbledhje informacioni nga studentet nepermjet pyetesoreve (Ev. 11). Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen ne raportin vjetor institucional dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit (Ev. shtese 34). Institucioni bashkepunon edhe me aktore te jashtem per vleresimin e performances se aktivitetit akademik dhe institucionit ne teresi: – Prej 3 vitesh behet anketim i studenteve dhe stafit nga Instituti per Cilesi ne Arsim (Ev. shtese 16). – Kontroll i pervitshem nga MAS per plotesimin e standarteve te stafit akademik dhe infrastruktures, rezultatet e te cilit pasqyrohen ne raportin e grupit te punes qe i dergohet edhe institucionit (Ev. shtese 32).
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Universiteti Aldent, ne fund te cdo viti akademik pergatit analizen vjetore qe eshte nje permbledhje e analizes se cdo njesie kryesore dhe perfshin veprimtarine akademike me rezultatet e pritshme, rezultatet e vleresimit, arrijtjet me te mira, mangesite e mundshme dhe masat e marra për adresimin e tyre (Ev. shtese 31). NJSBC si strukturë përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, analizon dhe vlerëson përputhshmërinë e programit të studimit me standardet shtetërore të cilësisë për programet dhe për institucionin. Gjithashtu, ne raportin vjetor te NJSBC perfshihen rezultatet e pyetesoreve te studenteve, te cilat analizohen dhe bazuar ne rezultatet e vleresimit, NJSBC ka hartuar planin e masave per rritjen e cilesise me strukturat përgjegjëse dhe afatet e realizimit (Ev. 8; Ev. 11).
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës,	UAL ka përdorur një sërë mekanizmash dhe metoda të drejtpërdrejta në kuadër të vlerësimit, realizimit dhe mbarëvajtjes te cilësisë së programit të studimit si përfshirja e studentëve në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit; procesi i vetëvlerësimit si nje strategji per reflektim dhe permiresim; iniciativa për rishikim të kurrikulave me qëllim përmirësimin e programit të studimit; procedura per monitorimin e dokumentacionit dhe sezonit te provimeve ne

kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	kuader te transparencës së vlerësimit për të identifikuar dhe minimizuar paragjykimet e mundshme gjate këtij procesi (Ev. 3.9; Ev. shtese 21, 30; Ev. 8; Ev 3.6). Nga ana tjetër departamentet e FSHMT analizojne mbarevajtjen e programit te studimit duke reflektuar vleresimin e tij ne raportin e analizes vjetore (Ev. shtese 31). Ne analizen vjetore te FSHMT, ne te cilin ofrohet programi Bachelor Teknik laboratorj jane analizuar keto elemente: – Cilesia ne mesimdhenie – Transparenca ne provime – Veprimtaria shkencore dhe akademike e departamentit – Kurrikulat dhe programet Ne raport jepet informacion i plote mbi realizimin e mesimdhenies ne auditor dhe mbikqyrjen e studenteve gjate oreve laboratorike dhe praktikave nga pergjegjesit e caktuar te cilet raportojne mbi frekuentimin dhe performancen e studenteve ne realizimin e tyre (Ev. shtese 31). Ne syllabuset e lendeve pershkruhet qarte menyra e vleresimit te studenteve nepermjet testimeve, seminareve, detyrave te kursit, projekteve etj. (Ev.27). Bazuar ne dokumentacion por edhe ne takimin qe GVJ realizoi me stafin dhe studentet u konstatua se studentet perfshihen ne diskutime te hapura dhe japin mendimin e tyre ne lidhje me procesin mesimor dhe problematikat qe hasen (Ev. 3.9; Ev. shtese 10 vizita institucionale). Gjithashtu institucioni disponon informacion mbi rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera, te cilat gjenden ne tabelat permbledhese (Ev. 23; Ev. shtese 36).
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e	Institucioni ka perdorur nje numer instrumentash të tërthortë per te vleresuar realizimin dhe mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit. GVJ e evidentoi kete vleresim nepermjet informacionit te perpunuar nga Zyra e Keshillimit te Karrieres dhe Alumni si edhe rezultatet e pyetesoreve te studenteve. Permes kesaj zyre behet gjurmimi i studenteve te cilet kane perfunduar kete program studimi dhe evidentohen pozicionet e punesimit dhe kualifikimeve te metejshme (Ev. 3.8). Njekohesisht institucioni analizon rezultatet e pyetesoreve te studenteve me qellim permiresimin ne vazhdimesi (Ev. 8; Ev.11).

Handwritten signature: Hoto Retany

administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Tutorët/Kujdestarët e grupeve mësimore kontaktojnë vazhdimisht dhe intervistojnë studentet në lidhje me procesin mesimor (Ev. 3.9). Stafi mesimor dhe mbikqyresit e praktikave raportojnë mbi problematikat që mund të hasen në procesin mesimor si edhe në mbarevajtjen dhe anagazhimin e studenteve në praktikat mesimore (Ev. 18).			
Konkluzione	<i>Universiteti Aldent përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit. Disa nga instrumentet e përdorur janë vlerësimi i performances së stafit akademik dhe ndihmes/akademik, pyetesoret e studenteve për vlerësimin e programeve dhe cilësisë në mesimdhënie, raporte dhe analiza vjetore në nivel fakultet dhe institucional, monitorime nga NJSBC në nivel institucional.</i> <i>Institucioni bashkëpunon edhe me aktore të jashtëme për vlerësimin e performances së aktivitetit akademik dhe institucionit në teresi si anketim i studenteve dhe stafit nga Instituti për Cilesi në Arsim, kontroll i përvitshëm nga MAS për plotësimin e standarteve të stafit akademik dhe infrastruktures.</i> <i>Institucioni ka përdorur një sërë mekanizmash dhe metoda të drejtpërdrejta dhe të terthorta në kuadër të vlerësimit, realizimit dhe mbarëvajtjes të cilësisë së programit të studimit</i> <i>Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes së cilësisë të programit të studimit analizon në raportet vjetore rezultatet e procesit të anketimit të studenteve me qëllim përmirësimin e programeve të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Alb Retaj

Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Ne statutin dhe rregulloren e UAL, por edhe ne rregulloren e NJSBC pershkruhet qarte perberja e Njesise se Sigurimit te Brendshem te Cilesise qe garanton perfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit (Ev. 1; Ev. 3.1; Ev. 3.3). Kjo strukture perbehet nga 1 anetar per cdo fakultet te UAL, 1 ekspert i jashtem dhe nje perfaqesues i unionit studentor. Gjitheperfsirja, vecanerisht perfaqesimi i studenteve ne kete strukture e ben efektive kontributin e tyre ne sigurimin e cilesise se programit te studimit (Ev. 23, tabela 9). Gjithashtu ne mbeshtetje te procesit akademik jane perfshire edhe aktore te tjere te brendshem te interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit si personeli i pritjes, tutorët akademike, pergjegjesit e programeve, drejtuesit e njesive baze, sekretaria mesimore etj.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Ne rregulloren e NJSBC, UAL dhe FSHMT jane percaktuar qarte përgjegjësite dhe detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit (Ev. 3.1; Ev. 3.2; Ev. 3.3). GVJ, gjate takimit me perfaqesues dhe drejtues te veprimtarise akademike ne institucion si Dekania e FSHMT, drejtuesit e departamenteve, perfaqesues te stafit akademik, studente, anetare te grupit te vetvleresimit, perfaqesues te NJSBC dhe Zyres se Karrieres, konstatoi se te gjitha keta aktore kane ushtruar me pergjegjesi detyrat e tyre duke bashkepunuar, koordinuar dhe bashkevepruar konform rregullave per te realizuar ne menyre korrekte procesin e akreditimit dhe sigurimit te brendshem te cilesise. Nga ana tjetere studentet referuan se jane te perfshire permes pyetesoreve, perfaqesuesve te tyre ne keshillin studentor per adresimin e problematikave dhe ne grupin e vleresimit te brendshem duke dhene kontributin e tyre ne permiresimin e programit te studimit dhe sigurimin e cilesise (Takimi ne institucion).
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit	NJSBC funksionon ne nivel institucioni dhe ndjek nje politike te transparences ne lidhje me proceset e ndryshme te cilesise duke rritur besimin dhe pergjegjshmerine e gjithsecilit ne mbarevajtjen e programit te studimit. NJSBC koordinon sigurimin e cilesise se programeve te studimit me te gjitha njesite baze te institucionit. Ne zbatim te rregullores, njesia baze garanton perfshirjen e te gjitha strukturave pergjegjese per

akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentëve (Ev. 3.3).
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Procesi ciklik i vlerësimit të brendshëm i nënshtrohet Kodit të Etikës i cili është hartuar nga UAL në zbatim të Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe realizohet në bashkëpunim me NJSBC. Anëtarët e komisioneve të lartpërmendura përbëhen nga anëtarë të stafit akademik me eksperiencë dhe integritet, të cilëve u respektohet liria, etika akademike dhe kuadri ligjor për mbrojtjen e të dhënave. Në procesin e vlerësimit respektohet integriteti akademik dhe shmanget çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve (Ev 1 Statuti, neni 26; Ev. 3.3). GVJ konstatoi se pyetësi i vlerësimit të programit të studimit është plotësuar duke respektuar anonimitetin dhe nuk janë referuar ankesa nga stafi apo studentet për pabarazi dhe diskriminim.
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit që lidhet me përberjen e NJSBC, GVJ konstatoi se në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, institucioni ka përfshirë edhe ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit. Institucioni, për të rritur sigurimin e brendshëm të cilësisë, përdor komentet/sygjerimet/vërejtjet si nga studentët ashtu edhe nga personeli akademik por edhe reage nga burime të jashtme si komunitetet profesionale, në të cilat janë punësuar të diplomuarit e UALne funksion të përmirësimit të programit të studimit dhe lidhjes me kërkesat e tregut të punës (Ev. 3.3). Kompani të trajnimit dhe punësimit ndërkombëtar që kanë ardhur në institucion, staf akademik i huaj në kuadër të projekteve Erasmus dhe bashkëpunimeve ndërinstitucionale kanë dhënë gjithashtu ekspertizën e tyre në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin të tij. (Ev. 10; Ev. shtesë 2, 3, 5).
Konkluzione	<i>Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UAL, është ngritur dhe funksion Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila përbehet nga 1 anëtar për çdo fakultet të UAL, 1 ekspert i jashtëm dhe një përfaqësues i unionit studentor.</i> <i>Gjithëpërfshirja, vecanërisht përfaqësimi i studentëve në këto struktura të ben efektive kontributin e tyre në sigurimin e cilësisë së programit të studimit.</i>



	<i>NJSBC koordinon sigurimin e cilesise se programeve te studimit me te gjitha njesite baze te institucionit.</i> <i>Ne procesin e vleresimit respektohet integriteti akademik dhe shmanget çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</i> <i>Ne procesin e vleresimit dhe sigurimin e brendshem te cilesise, institucioni ka perfshire edhe ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit te cilet japin ekspertizen e tyre ne lidhje me permiresimin e programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe janë bërë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare të UAL, https://ual.edu.al/ual.edu.al/ Gjithashtu, statuti i UAL, rregulloret, raportet vjetore, vendimet e organeve kolegjiale, raportimet periodike të rektoratit që lidhen me procesin mësimor dhe sigurimit të cilësisë së mësimdhënies, janë të aksesueshme në faqen zyrtare të institucionit. (Faqja e webit te UAL)
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	NJSBC realizon pyetësoret e studenteve (Ev. 11) dhe publikon rezultatet e tyre ne kuader te transparences dhe duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale (ligji 9887/10.03.2008). Gjithashtu NJSBC publikon raportin vjetor, te cilin ia percjell senatit akademik ku diskutohen problematikat e evidentuara dhe mundesite per permiresim (Ev. 8). Institucioni publikon raportin e vetvleresimit te brendshem dhe adreson gjetjet apo rekomandimet e lëna në raportet respsektive (Ev. shtese 30).
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan	Raporti i auditimit te brendshem percillet ne senat se bashku me nje plan masash që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. Procesi i auditimit te

Handwritten signature/initials in blue ink.

masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	brendshëm miratohet nga rektori. Rektori bashkë me NJSBC monitoron zbatimin e plan masave i cili reflektohet edhe ne raportin vjetor te NJSBC (Ev. 8; Ev. shtese 21 Praktika e auditimit). Gjithashtu, ne kuader te procesit te akreditimit institucional, rezultatet e ketij vleresimi te brendshëm u raportohen rektoratit dhe dekanateve te fakulteteve te cileve u lihet per detyrë përmbushja e rekomandimeve të dala nga ky process (Vizita ne institucion, takimi me GVB).
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Gjate shqyrtimit te dokumentacionit, GVJ evidentoi se raportet vjetore shoqerohen me plane masash ose adresim problematikash te cilat synojne permiresimin e mangesive te identifikuar me impakt rritjen e cilësisë së programit të studimit (Ev. shtese 30, 31).
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Ne takimin me perfaqesues te NJSBC, Zyren e Karrieres dhe studentet, GVJ u informua se institucioni organizon aktivite periodike me qellim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Kjo reflektohet edhe ne dokumentacionin e vene ne dispozicion ku jepen te dhena per nje sere aktivitetesh te zyles se karrieres dhe keshillit studentor (Ev. shtese 11 Aktivite për Studentët). Gjithashtu nen kujdesin e perfaqesuesit te NJSBC, tutoriatit akademik dhe pergjegjesve te programeve organizohen aktivite me stafin akademik per rritjen e cilesise ne mesimdhenie dhe programin mesimor (Ev. 23, tabela 17 Aktivitetet e stafit).
Konkluzione	<i>Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe jane bërë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare të UAL.</i> <i>Ne kuader te procesit te akreditimit institucional, rezultatet e ketij vleresimi te brendshëm u raportohen rektoratit dhe dekanateve te fakulteteve te cileve u lihet per detyrë përmbushja e rekomandimeve të dala nga ky proces.</i> <i>Raportet vjetore te FSHMT shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</i> <i>Institucioni organizon aktivite periodike me qellim informimin dhe ndërgjegjësimin e stafit akademik dhe</i>

	<i>studenteve për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në:
“Teknikë laborator mjekësor”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Universiteti “Aldent” ka mbi 20 vite përvojë në arsimin e lartë dhe ka ofruar vazhdimisht standarde të larta në mësimdhënie dhe aktivitete shkencore;
2. Stafi akademik ka një përbërje të mirë, duke përfshirë profesionistë me tituj shkencorë dhe përvojë të gjerë në fushën mjekësore;
3. Universiteti disponon infrastrukturë moderne, me laboratorë të pajisur mirë dhe mjedise të përshtatshme për zhvillimin e mësimin teorik dhe praktik. Zhvillimi i teknologjive të reja ofron mundësinë për të përfshirë teknologji të automatizimit dhe inovacione të avancuara në laboratorët mjekësorë;
4. Universiteti ka ndërtuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione shëndetësore dhe laboratorë, duke siguruar mundësi praktike të rëndësishme për studentët;
5. Programi është projektuar për t’iu përshtatur kërkesave të tregut të punës, duke përfshirë aftësi praktike dhe përdorimin e teknologjive të avancuara. Kërkesa e shtuar për profesionistë të kualifikuar në tregun shëndetësor nxjerr në pah rëndësinë e formimit të teknikëve laboratorikë me aftësi dhe njohuri të avancuara;
6. Rritja e bashkëpunimeve ndërkombëtare synon zgjerimin e marrëdhënieve me universitete dhe institucione të huaja, duke krijuar mundësi për shkëmbime akademike dhe kërkime shkencore;
7. Përditësimi i planit mësimor përmes integritetit të lëndëve dhe temave të reja synon përmirësimin e cilësisë dhe rritjen e atraktivitetit të programit të studimit;

b. Pikat e Dobëta:

Handwritten signature: Retory

1. Mungesa e evidencave të detajuara dhe statistikave të mirëdokumentuara për Alumni nga Urdhrat profesionale në lidhje me punësimin, pavarësisht deklarimeve verbale të bëra gjatë takimit; (*Standardit V.4, Kriteri 3*)


Rekomandime:

1. Të rritet bashkëpunimi me urdhrat profesionale për të vlerësuar më saktë shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve. Ky informacion duhet të pasqyrohet në mënyrë të qartë në raportin analitik institucional, duke u shoqëruar me masat e duhura për të përmirësuar këta tregues;
2. Institucioni të ruaj dhe të hartojë dokumenta të specifikuar për studentët e diplomuar në lidhje me punësimin e tyre;

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor Medical Laboratory Technique

a. Strengths and Affirmations:

1. "Aldent" University has over 20 years of experience in higher education and has consistently maintained high standards in teaching and scientific activities;
2. The academic staff is well-composed, including professionals with scientific titles and extensive experience in the medical field;
3. The university has modern infrastructure, featuring well-equipped laboratories and facilities suitable for both theoretical and practical learning. The development of new technologies enables the integration of automation and advanced innovations in medical laboratories;
4. The university has established cooperation agreements with healthcare institutions and laboratories, providing significant practical opportunities for students;
5. The program is designed to meet the demands of the job market, incorporating practical skills and the use of advanced technologies. The growing demand for qualified professionals in the healthcare sector highlights the importance of training laboratory technicians with advanced skills and knowledge;
6. The increase in international collaborations aims to expand relationships with foreign universities and institutions, creating opportunities for academic exchanges and scientific research;
7. The curriculum is regularly updated through the integration of new subjects and topics, aiming to improve quality and enhance the attractiveness of the study program;



b. Weaknesses

1. The lack of detailed evidence and well-documented statistics regarding alumni employment, as provided by Professional Orders, remains evident despite verbal statements made during the meeting; (*Standard V.4, Criterion 3*)

Recommendations

1. Strengthen collaboration with Professional Orders to more accurately assess the rate and quality of student employment. This information should be clearly reflected in the institutional analytical report, accompanied by appropriate measures to improve these indicators;
2. The institution must maintain and draft specified documents for graduate students regarding their employment;

Alto Retory

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Auto-Rekord